GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7443 E shtunë 17 Shkurt **2018** **Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)**

Intervista e Ditës

Nga DURIM ABDULLAHU

"Pavarësia e Kosovës, fitorja e dytë e shqiptarëve"

Ish-kryeministri Sali Berisha në intervistën e dhënë për një media kosovare tregon të gjithë historinë e tij me Kosovën, nga bisedat kur ishte president ...

Vijon në faqet 18-19

Opimioni i Ditës

Nga "DEUTSCHE WELLE"

BE qorton Facebook dhe Twitter

Në një kohë kur Google i ka përshtatur rregullat e platformës së saj Google plus në një masë të konsiderueshme me kërkesat e Komisionit, Facebook dhe ...

Vijon në faqen 22

Zëdhënësja e Departamentit Amerikan: Ky është rasti i parë

SHBA i ndaloi hyrjen, Adriatik Llalla flet për mediat amerikane: Lu keqinformoi DASH

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendos ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për ish-kryeprokurorin

Nga DARINA TANUSHI

Ish-Prokurori i Përgjithshëm, Adriatik Llalla fajësoi ambasadorin amerikan në Tiranë, Donald Lu për keqinformim të Departamentit të Shtetit në lidhje me të. Llalla reagoi dje për herë të parë pas vendimit të Departamentit ...

Në faqen 3

HYN NE FUQI BUXHETI AFATMESEM, FONDET PER PRONAT DHE TE BURGOSURIT POLITIKE

KOMPENSIMI I ISH-PRONAREVE, QEVERIA JEP 13.6 MLD LEKE

Ministria e Drejtësisë: Fondet për pagesat e përfituesve do rriten çdo vit. Fondi i dëmshpërblimit për ish-të përndjekurit 6.5 miliardë lekë

(Në foto) Toka. Ish-të përndjekur në protestë

Në faqen 9

OPOZITA KERKON INTERPELANCE

Bushati takon Kotzias në Sofje. Rama: S'dua të mendoj se Meta ka axhendë politike për ta dëmtuar

Në faqen 4

NGJARJA NE SELITE

Plagoset rivali i Shullazit, shpallen në kërkim babë e bir. E shkuara e Gjon Pelivanit

Në faqen 6

SOT 10-VJETORI

Pavarësia e Kosovës, Haradinaj kundër Ramës: Merru me vendin tënd

Në faqen 5

DOSSIER

Dokumenti sekret i Sigurimit: Si e kapëm Prek Calin me 12 krerë të reaksionit në Kelmend

Në faqet 21-22

BLUETOOTH

Rrëfehet "Sophie" e Çanit: Endrra ime. 10 vjet pavarësi, ku do jenë Ledri e Rita Ora

Suplement

Dosja për marrjen e tapisë dorëzohet nga Agjencia e Legalizimeve në Hipotekë

ALUIZNI, 1900 personat që do të marrin tapitë

Legalizimet, ja kush përfiton në qarkun e Elbasanit

Nga ORNELA MANJANI

ALUIZNI publikon listën me 1900 persona që kanë ndërtuar pa leje dhe kanë gati lejet e legalizimeve. Përfituesit janë në qarkun e Elbasanit. Drejtoria e ALUIZNI-t bën të ditur se lejet e legalizimeve

kanë qenë gati prej kohësh, madje janë dorëzuar edhe në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, por kjo e fundit nuk ka kryer asnjë veprim për pajisjen me certifikatë pronësie të përfituesve. ALUIZNI bën të ditur se ...

Në faqet 11-12

DREJTESIA
DEBATI

Shkarkimi i kryeprokurores, ekspertët e PS-PD përplasen në Këshillin e Legjislacionit

Vetingu, PS: Mbrojtët prokurorin non-grata, PD: Largimet nga frika

Gjonaj: Duroni, erdhën rezultatet e para

Valentina Madani

Demokratët e cilësojnë antikushtetuese zgjedhjen në seancën e 18 dhjetorit të kryeprokurores së përkohshme, Arta Marku. Opozita kërkon që deri në zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm, funksionet e tij të ushtrohen nga një prokuror i caktuar nga Kuvendi, me tre të pestat e anëtarëve të tij, mes kandidaturave të propozuara nga Gjykata Kushtetuese, për një mandat të përkohshëm e që të kenë kaluar vetingun. Ndërsa për maxhorancën procedura e ndjekur nga parlamenti është në përputhje me ligjin themeltar të shtetit dhe se zëvendësimi i Arta Markut do të bëhet pas ngritjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ndarja e qëndrimeve mes palëve u vu re edhe në prezantimin e dy raporteve nga ana e ekspertëve të partive politike në mbledhjen e djeshme të Këshillit të Legjislacionit. "Me ngritjen e KLP shpallet menjëherë vakanca për Prokurorin e Përgjithshëm, e cila qëndron e hapur për 30 ditë dhe 45 ditë janë të nevojshme për verifikimin e përmbushjes së kritereve dhe renditjen e kandidatëve. Raporti i dërgohet menjëherë Kuvendit, i cili brenda 30 ditëve zgjedh Prokurorin e Përgjithshëm. Në vlerësimin tim, më shpejt zgjidhet Prokurori i Përgjithshëm nga ngritja e KLP-së, se sa do jenë efektive dispozitat e propozuara për ndryshime Kushtetuese"- Besmir Beja ekspert i mazhorancës. Kurse eksperti i thirrur nga opozita, Ilir Qafa, shprehu bindjen se Marku u zgjodh në kundërshtim me Kushtetutën dhe një zgjedhje e rregullt e një prokurori të përkohshëm kërkon ndryshime në aktin themeltar të shtetit. "Procesi i realizuar është kryer në një boshllëk kushtetues, në një boshllëk ligjor. Dispozitat kushtetuese në fuqi nuk mund të anashkalohen, as me ligj, as me vendim të organeve kushtetuese, as me vendim të Kuvendit dhe as me vendim të Komisionit të Ligjeve. Nëse një rregull kushtetues në fuqi është i pamundur nga pikëpamja faktike për t'u zbatuar, atëherë është në detyrim të Kuvendit që të miratojë një dispozitë transitore Kushtetuese. Ka dalë e qartë se zgjedhja ekskluzive politike vetëm e Kuvendit me shumicë të thjeshtë, nuk është në harmoni me standardin kushtetues të pavarësisë së organit të prokurorisë",-tha z.Qafa.

DEBATI

Dorëheqjet e para në sistemin e drejtësisë, si gjyqtari Besnik Imeraj apo largimi nga drejtësia edhe e ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla, konsiderohen nga mazhoranca si rezultati i parë i suksesshëm i vetingut, por opozita në Komisionin e Integrimit shprehet se nuk është sistem drejtësie largimi i disa frikacakëve. Etilda Gjoni ministre e Drejtësisë, u shpreh në komision: "Për sa u takon rezultateve të reformës në drejtësi, rezultatet e para i kemi. Dhe janë pikërisht dorëheqjet e fundit që janë bërë nga anëtarë gjykatash, ish-prokurorë të përgjithshëm, të cilët ishin në listën prioritare për t'u 'vetuar' nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Rezultatet e para kanë ardhur, të jemi të duruar". Ndërkohë deputetja socialiste Elisa Spiropali kritikoi opozitën: "Protestuat për të mbajtur në detyrë një kryeprokuror, i cili tashmë është shpallur non grata në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Procesi i reformës në drejtësi dhe vetingu kanë filluar të japin rezultatet e para dhe nuk ka gjë më të rëndësishme se kjo në procesin e integrimit të Shqipërisë. Po vetëlargohen nga sistemi gjyqtarë e prokurorë, të cilët nuk duan të kalojnë përmes vetingut" - tha ajo. Por deputetja demokrate Grida Duma e sheh me skepticizëm suksesin e reformës: "Po planifikojmë një sistem drejtësie i cili nuk ka rezultat kur disa njerëz largohen nga frika. Besoj që kjo duhet të jetë edhe deviza juaj. Nuk është çështja që të krijojmë një sistem që disa njerëz të largohen nga frika dhe të themi që kemi ngritur një sistem drejtësie".

NDARJA

Ekspertët e propozuar nga PS në argumentet e tyre mbrojnë procedurën që u zgjodh Arta Marku, ndërsa kërkojnë rrëzimin e kërkesës së opozitës. Por ekspertët e propozuar nga PD dhe LSI në një material voluminoz prej 22 faqesh argumentojnë se maxhoranca me zgjedhjen e prokurorit të përkohshëm shkeli kushtetutën dhe cenoi pavarësinë e institucionit.

Prioritet i punës së Komisionit Zgjedhor

Bylykbashi: Votimi elektronik nuk do të lejojë mbushjen e kutive

Komisioni i Reformës Zgjedhore përcaktoi votimin elektronik si prioritet të tij. Deputeti demokrat Oerd Bylykbashi, që është bashkëkryetar i komisionit për këtë reformë, shkruan në "FB" se identifikimi biometrik do t'i japë fund manipulimit me kartat false, ndërsa votimi elektronik nuk do të lejojë mbushjen e kutive. "Identifikim biometrik që askush të mos manipulojë me karta false, të falsifikojë firmat e emigrantëve apo t'u bllokojë zgjedhësve votën duke u marrë kartat e identitetit. Votim e numërim elektronik që askush të mos mbushë kutitë e votimit apo të vjedhë votat në numërim. Sistem i thjeshtë, transparent dhe i besueshëm për zgjedhësit, partitë dhe publikun. Ekspertë e huaj e thonë qartë: kërkon kujdes, por është plotësisht e bështme. Partneret e huaj po ashtu mbështesin qasjen e kujdesshme të komisionit për votim elektronik në qendër votimi, jo online! Komisioni hodhi shinat për një reformë të suksesshme e konsensuale. Kjo reforme është më e rëndësishmja. Vetëm një parlament pa votë të blerë dhe pa kriminelë mund të bëjë drejtësi të vërtetë. Zgjedhjet janë prioritet për demokracinë dhe integrimin europian. Opozita do t'i prijë këtij interesi jetik", - shkruan deputeti i PD-së Oerd Bylykbashi.

PD kërkon shkarkimin e anëtarit të KLGJ

Strazimiri: Muharremaj punon për llogari të PS

PD do t'i kërkojë zyrtarisht parlamentit shkarkimin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Gjyqësorit , Erjon Muharremaj, i cili është edhe zv/ dekan i Fakultetit të Juridikut. Deputeti i PD, Gent Strazimiri tha se Muharremaj është i përfshirë në aktivitete politike për llogari të PS. PD kërkon dhe shkarkimin e dekanit të Fakultetit të Drejtësisë Artan Hoxha. "Mediat publikuan të enjten prova sesi Dekani Artan Hoxha, një ish-hetues i diktaturës, e ka shndërruar Fakultetin e Drejtësisë në zyrë reklamash e rekrutimi për Fondacionin POLITIK të Partisë Socialiste, "Qemal Stafa", që, deri dje drejtohej nga ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, nën hetim për trafik ndërkombëtar droge. Zëvendës dekani Erjon Muharremaj, i cili ka shpërndarë me email këtë ofertë të 'partisë', është edhe një nga individët që supozohet të përzgjedhë "punonjësit e drejtësisë së re", asaj "të paanshmes", "të drejtës", "të papërlyerës" me politikë", tha z.Strazimiri. PD do t'i kërkojë parlamentit dhe zyrtarisht shkarkimin e anëtarit të KLGJ Erjon Muharremaj për përfshirje në aktivitet politik për llogari të partisë së Edi Ramës ashtu sikurse bën thirrje për shkarkimin e shefit të tij, dekanit të Fakultetit të Drejtësisë Artan Hoxha. Po kush janë individët që sipas PD-së po bëjnë drejtësinë e re? "Dy spiunë, dy persekutorë, dy të skualifikuar nga ONM, dy persona thellësisht politik. Për rastin "Muharremaj", megjithëse i klasifikuar i nivelit mediokër nuk kishte prova që është i zyrtarisht "i Partisë"! Qenka jo vetëm i Partisë, por "shkencërisht" i Partisë",-tha deputeti i PD-së. Kjo nuk është një "drejtësi e re" tha ai, por drejtësi me ish-sigurimsa.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI,
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116, ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.gsh.al, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

KONTROLLI

Adriatik Llalla bëhet subjekti i dytë pas anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, Besnik Imeraj, që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit merr vendim për t'i ndërprerë procesin e verifikimit. Mësohet se të parët që janë shortuar për t'u kontrolluar janë rreth 60 gjyqtarë dhe prokurorë, anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, kandidatët për KLP e KLGJ, si dhe krerët e gjykatave dhe prokurorive në rrethe.

Donald Lu në Turqi, takon sekretarin e DASH, Tillerson

Donald Lu është takuar në Turqi me Sekretarin Amerikan të Shtetit, Rex Tillerson. Gjatë vizitës së tij në Turqi, Tillerson u takua me ambasadorët amerikanë që shërbejnë në Ballkan, Kaukazinë Jugore dhe Mesdheun Lindor. Vetëm dy ditë më parë, Sekretari i Shtetit, Rex Tillerson miratoi masën e ndalimit të udhëtimit në SHBA për ish-kryeprokurorin Adriatik Llalla dhe familjen e tij, për shkak të përfshirjes në raste të mëdha korrupsioni. Pak ditë më parë, përmes dy mesazheve në "Twitter", shefi diplomacisë amerikane në Tiranë kërkoi që historia e Adriatik Llallës të mos mbyllet me kaq. Në mesazhin e parë Lu tha: "Vendimi për t'u tërhequr është një vendim personal, por largimi i çdo gjykatësi apo prokurori të korruptuar, apo të paaftë është një fitore në betejën për një sistem drejtësie më të mirë. Ata nuk mund të rikthehen në sistem për 15 vjet". Ambasadori Lu megjithëse nuk e përmend emrin e Adriatik Llallës, referimi i drejtohet pikërisht atij. "Vendimi për t'u tërhequr nuk i shfajëson këta ish- zyrtarë nga përgjegjësitë e mundshme penale për korrupsion apo shpërdorim detyre. Ata që kanë frikë nga vetingu duhet të kenë frikë edhe nga hetimet e pashmangshme penale", thuhet më tej në reagimin e ambasadorit amerikan.

DEKLARATA

"Vendimi për t'u tërhequr është një vendim personal, por largimi i çdo gjykatësi apo prokurori të korruptuar, apo të paaftë është një fitore në betejën për një sistem drejtësie më të mirë. Ata nuk mund të rikthehen në sistem për 15 vjet".

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ndërpret rivlerësimin për ish-kryeprokurorin

"Non grata" në SHBA, Llalla: Lu më ka fyer, na ka trajtuar si kriminelë

Zëdhënësja e DASH: Rasti i parë i një ndalimi publik

Darina Tanushi

Ish-Prokurori i Përgjithshëm, Adriatik Llalla fajësoi ambasadorin amerikan në Tiranë, Donald Lu për keqinformim të Departamentit të Shtetit në lidhje me të. Llalla reagoi dje për herë të parë pas vendimit të Departamentit Amerikan të Shtetit, që i ndalon hyrjen në SHBA atij, gruas dhe dy prej fëmijëve. Në një intervistë për median amerikane "Wall Street Journal", ish-kryeprokurori tha: "Unë jam i sigurt se ky është një vendim i marrë pas një keqinformimi të dhënë nga ambasadori Lu në Departamentin e Shtetit. Lu më ka fyer mua, familjen time gjithashtu dhe gjithë trupën e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Shqipëri. Lu na ka trajtuar si kriminelë, duke na denigruar publikisht dhe personalisht", tha ai. Në vendimin e DASH për ndalimin e hyrjes në SHBA për Llallën thuhet se është i "përfshirë në korrupsion madhor, ose shkelje të rënda të të drejtave të njeriut".

Llalla tha se viza e tij dhe e gruas së e tij u eliminua vitin e kaluar sepse bashkëshortja e tij udhëtoi për në SHBA me një pasaportë diplomatike për shkak të problemeve shëndetësore. "Ajo ishte shtatzënë në kohën e udhëtimit", tha ai dhe gruaja e tij e lindi fëmijën e tyre teksa ishte në SHBA. Lalla tha më pas se Lu-ja i kishte thënë se zyrtarët nuk mund të përdorin vizat diplomatike për vizita private. Nga ana tjetër, një zëdhënëse e Departamentit Amerikan të Shtetit sqaroi në përgjigje për "Report TV" deklaratën e Sekretarit të Shtetit, Rex Tillerson, duke theksuar se është hera e parë që një Sekretar Shteti merr një vendim kaq ekstrem dhe e shpall publikisht.

Zëdhënësja e DASH tha: "Seksioni 7031 përfshin kërkesën që duhet të ndërmarrë Departamenti i Shtetit për të publikuar, ose në mënyrë private për ndalimin e personit. Ky lloj autoriteti është efektiv që prej vitit 2008 dhe ky është rasti i parë i një ndalimi publik bazuar në ligjin 7031". Kjo tregon qartë qëndrimin e SHBA-ve në mbështetje të reformës në drejtësi. Ambasadori Donald Lu ka pasur jo pak përplasje me ish-kryeprokurorin Adriatik Llalla, duke e cilësuar si pengesë për reformën në drejtësi.

VENDIMI

Ndërkohë dje, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në Shqipëri vendosi ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, ish-Prokurorin e Përgjithshëm, Adriatik Llalla. Në një njoftim për mediat në faqen zyrtare të KPK thuhet: "Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se trupi gjykues, i përbërë nga Roland Ilia kryesues, Pamela Qirko, anëtare, Olsi Komici relator, pasi mori dijeni për dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit, z. Adriatik Llalla, më datë 12.02.2018, në zbatim të nenit G të aneksit të Kushtetutës, vendosi ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Adriatik Llalla". Po ashtu, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit bënë të ditur se, "vendimi do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni në zbatim të afatit të përcaktuar në nenin 55/7 të ligjit nr. 84/2016, 'Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'". Por ka edhe raste se si mundet të shpëtojë. Zëvendëskomisionerja Aldona Sylaj shpjegoi dje për "Fax News" se pas vendimit të treshes që vendosin të "përjashtojnë" Llallën nga vetingu, Komisioneri publik mund ta apelojë këtë vendim në Kolegjin e Apelit. Ky apelim bëhet ose me iniciativë të tij, duke pasur parasysh interesin publik ose me rekomandimin apo këshillimin e ONM-së. Në rast se Kolegji i Apelit pranon kërkesën e Komisionerit publik që Llalla mos i nënshtrohet vetingut, atëherë ai përfundimisht largohet nga sistemi i drejtësisë, në të kundërt Llalla do t'u nënshtrohet filtrave të vetingut. Momentalisht Adriatik Llalla është jashtë strukturës së sistemit të drejtësisë, pasi nuk ushtron asnjë detyrë qysh prej dhjetorit të kaluar kur postin e tij e zuri Arta Marku.

DEKLARATA

"Unë jam i sigurt se ky është një vendim i marrë pas një keqinformimi të dhënë nga ambasadori Lu në Departamentin e Shtetit. Lu më ka fyer mua, familjen time, gjithashtu edhe të gjithë trupën e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Shqipëri. Lu na ka trajtuar si kriminelë, duke na denigruar publikisht dhe personalisht", tha Llalla.

Prokuroria e Përgjithshme: Ndëshkim cilitdo që cenon parimet e shtetit

Prokuroria e Përgjithshme nuk i dha një përgjigje të prerë kërkesës së "Zërit të Amerikës" për të mësuar nëse do të ndërmerret apo jo ndonjë veprim ndaj ish- kryeprokurorit Adriatik Llalla, pas vendimit të Departamentit Amerikan të Shtetit për t'i ndaluar atij hyrjen në Shtetet e Bashkuara për shkak të përfshirjes në raste të mëdha korrupsioni. "Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë i jep përparësi integritetit moral dhe profesional të zyrtarëve.

Populli shqiptar pret dhe meriton që zyrtarët të punojnë me ndershmëri dhe integritet në të mirë të interesit publik", thuhet në përgjigjen e Prokurorisë së Përgjithshme, ndërsa shton se ky institucion "u jep mbështetjen e plotë të gjithë prokurorëve që punojnë me përkushtim, dinjitet dhe integritet" e se "gjithashtu mbështet qëndrimin për ndëshkimin e cilitdo që cenon parimet e Shtetit të së Drejtës". Rasti i zotit Llalla është i pari i një zyrtari të lartë shqiptar, ndaj të cilit Shtetet e Bashkuara marrin sanksione të tilla. Javën e shkuar ish-kryeprokurori u tërhoq nga e drejta për të qenë gjykatës në Apel, duke preferuar të mbetet jashtë sistemit të drejtësisë.

Petrit Vasili: SHBA të sqarojnë çfarë dhe kë mbrojti Llalla

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili u shpreh dje se SHBA-të duhet të sqarojnë shpalljen "non grata" të ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla, gruas dhe dy fëmijëve të tij. Sipas Vasilit, deri tani dihet se shkaku është shkelja e gruas së Llallës që ka lindur një fëmijë në SHBA jashtë afateve. "E rëndësishme është çfarë ka konstatuar. Hyn apo nuk hyn më është çështje që i përket palës tjetër. Presim me padurim të dimë cili është shkaku i vërtetë. Në rast se kemi një akuzë për korrupsion, çështja ndahet në dy drejtime. Çfarë korrupsioni dhe kë ka mbrojtur zoti Llalla? Çfarë është ky, ndonjë politikan? Deri tani dimë që i është mohuar viza amerikane për shkak se gruaja e tij ka lindur në SHBA jashtë kohës", tha Vasili në "Report TV". "Nëse ka qenë për korrupsion, është interes i jashtëzakonshëm. Çfarë korrupsioni dhe kë ka mbrojtur!? Kjo është një çështje që nuk ka lidhje me vetingun. Heqja dorë e zotit Llalla nuk është i vetmi, ka shumë e shumë raste që janë tërhequr nga karriera. Unë s'merrem me argumentet e mazhorancës", tha ai.

MARREVESHJA
NEGOCIATAT

Negociatat me Greqinë, opozita kërkon interpelancë me ministrin Bushati

Pakti, Meta vijon konsultimet, Bushati takon Kotzias në Sofje

Shtatë pyetjet e opozitës për ministrin e Jashtëm

Valentina Madani

Prej tri ditësh Presidenti Ilir Meta ka ndërmarrë takime konsultative me ish- presidentët e vendit në lidhje plotfuqishmërinë për nisjen e negociatave me Greqinë. Z.Meta ka takuar paraardhësit Bamir Topi, Alfred Moisiu, Rexhep Mejdani dhe Sali Berisha. Gjithashtu, presidenti Meta pati konsultime dhe me kryetaren e Komisionit të Jashtëm Mimi Kodheli, ndërkohë që dje priti në Presidencë edhe Tritan Shehun nënkryetari i Komisionit parlamentar për Integrimin. Takimet konsultative zhvillohen pas kërkesës së Ministrisë së Jashtme për të marrë plotfuqishmërinë e Presidentit për të nisur negociatat zyrtarisht për një marrëveshje që pritet të nënshkruhet në muajin prill, atëherë kur Rama dhe Tsipras do të takohen dhe që palët duken shumë afër dakordësisë. Në fund Presidenti Meta do i drejtohet Ministrisë së Jashtme me një deklaratë zyrtare për këtë çështje. Por përparimi i marrëdhënieve bilaterale mes Shqipërisë dhe Greqisë, ishin në fokus të bashkëbisedimit mes ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati dhe ministrit të Jashtëm grek, Nikos Kotzias. Siç bën të ditur kryediplomati shqiptar në një postim në rrjetin social, takimi me homologun grek, Kotzias, u zhvillua në kuadër të takimit të ministrave të Punëve të Jashtme të BE-së (Gymnich), në Sofje.

OPOZITA

Po dje opozita i ka kërkuar kryetares së Komisionit të Jashtëm për të thirrur në një seancë dëgjimore ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati për të raportuar në lidhje me delimitimin e hapësirave detare ndërmjet dy vendeve Shqipërisë dhe Greqisë. Për opozitën ka një mungesë totale të transparencës nga ana e qeverisë shqiptare dhe përkatësisht të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme. Opozita kërkon që seanca dëgjimore të zhvillohet në datën 21 shkurt. Pyetjet që ngre opozita lidhen me kushtet e procedurat se kur deklarohet që është arritur apo ka marrë formë marrëveshja (që do të thotë se është ngritur grupi negociator), janë zhvilluar negociatat, palët në nivel ekspertësh kanë rënë dakord, dhe më pas zhvillohen diskutimet në nivele politike. Gjithashtu, këto pyetje bazohen edhe në faktin se nga Presidenti i Republikës deklarohet që deri më tani nuk është dhënë asnjë plotfuqishmëri për këtë proces shume të rëndësishëm. Kjo u konfirmua edhe nga kërkesa e bërë vetëm dje nga ministri Bushati për të kërkuar plotfuqishmërinë: Përse një marrëveshje e tillë zhvillohet në një mungesë totale të informimit të institucioneve kryesore të vendit, Kuvendi i Shqipërisë, opozita, shoqëria civile? Tashmë që u qartësua fakti i mos pasjes akoma të plotfuqishmërisë, ne kërkojmë të dimë edhe vlerësimin tuaj për këtë situatë jo normale, si dhe për vlefshmërinë e procedurave të ndjekura deri më tani? A është koordinuar me Presidentin për hapat e deri tanishme dhe mbi ç'bazë legale janë bërë ato? Cili është grupi negociator, çfarë përbërje ka, cili është niveli i përfaqësimit në këtë grup i ekspertëve të fushave, i ekspertëve nga opozita dhe nga shoqëria civile, në mënyrë që ky grup të jetë i pakontestueshëm dhe të përfaqësojë në mënyrë të drejtë të gjithë interesat kombëtare? Nëse është ngritur ky grup ekspertësh për të negociuar, cili është tagri që ka ky grup? Cilat zona po delimitohen dhe a duhej te përcaktoheshin me pare ato në aktin e plotfuqishmërisë së Presidentit të Republikës? Nëse është arritur marrëveshja në nivel politik sikurse është deklaruar nga ana e ministrit të Jashtëm të Republikës së Greqisë, a është kjo një shkeljen e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kur ka munguar edhe plotfuqishmëria e Presidentit? Nëse marrëveshja është arritur në nivel politik - çfarë u ngelet ekspertëve të bëjnë? Thjesht çertifikimin e marrëveshjes politike në një kohë që duhet të jetë e kundërta, bëhen negociatat në nivel eksperti e më pas nënshkruhet marrëveshja politikisht?

PAKTI, TOPI: PRESIDENTI NUK U NJOFTUA PËR ASGJË

Ish-Presidenti Bamir Topi, i ftuar dje në News24, foli për konsultimet në lidhje me marrëveshjen e detit me kreun aktual të shtetit, Ilir Meta. "Unë mendoj që kërkesa të ishte më mirë e drejtuar nga kryeministri tek presidenti, por në vitin 2009 kjo gjë nuk ndodhi. 2009 është shprehje e një arrogance politike, sjellje me tipare anti-shtet nga ish-kryeministri. Në rastin konkret, gjërat po bëhen në një terren tjetër. Në marrëveshjen e 2009, nuk u zbatua Kushtetuta. Besoj se do ketë disa raunde bisedimesh"- tha z.Topi.

KOTZIAS: ME SHQIPËRINË ÇËSHTJET E MBYLLURA PARA NJË MUAJI

Greqia i konsideron të mbyllura çështjet që kanë qenë prej shumë kohësh të hapura me Shqipërinë. Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias, në një intervistë të dhënë për televizionin "Alpha" theksoi prerë se Greqia i ka mbyllur gjithë çështjet hapura me Shqipërinë, dhe ka shprehur shpresën që së shpejti të kurorëzohet marrëveshja përfundimtare. Ai pranoi se paketa e çështjeve që ishin të hapura prej 70 vitesh tashmë kurorëzohet në një marrëveshje.

Pakti me Greqinë, Rama: S'dua të mendoj se Meta ka axhendë politike për ta dëmtuar

Kryeministri Edi Rama deklaroi dje, se nuk mendon se Presidenti Ilir Meta ka axhendë politike për të dëmtuar marrëveshjen për kufirin me Greqinë. I pyetur në një intervistë për Klan Kosova nga gazetari Baton Haxhiu, Rama u shpreh: "Nuk mendoj që presidenti refuzon, por se ai ka gjithë të drejtën e vet që ta qëmtojë këtë proces, i cili vjen në jetë pas një rezultati që ishte absolutisht i padenjë për qeverinë e mëparshme dhe i dëmshëm për Shqipërinë. Nuk dua të mendoj se presidenti është përfshirë në agjendë politike, për ta dëmtuar këtë proces. Përkundrazi, besoj se presidenti do që të jetë i qartë dhe i saktë". Ai tha: "Ne kemi një moment të artë për ta finalizuar atë për çka palët janë dakordësuar. Palët janë dakordësuar që të ketë një marrëveshje të re. Kjo do të thotë që jemi një hap nga finalizimi i një marrëveshje historike, që përfundimisht përcakton sovranitetin e Shqipërisë mbi territoret e veta dhe që mbyll një kapitull kur problemet e së shkuarës bëheshin probleme të së ardhmes". Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se marrëveshja për detin me Greqinë është afër finalizimit, pasi palët janë dakordësuar që të ketë një akord të ri, që përfundimisht do të përcaktonte sovranitetin e Shqipërisë mbi territoret e veta. "Ne kemi bërë një proces të vështirë, me tension të ngritur, sepse nuk kemi pranuar të heshtim përballë këtij problemi serioz, që ka të bëjë me integritetin territorial të Shqipërisë, për të drejtat e çamëve, për ligjin e luftës. Ne nuk jemi gati të mbyllim syrin për një gjë, apo ta lëmë të kalojë një gjë tjetër. Marrëveshja e re nuk do të jetë përsëritje e marrëveshjes së vjetër. Po të ishte për të humbur më shumë se ç'humbëm me marrëveshjen e vjetër, ne nuk do t'i hynim kësaj përpjekje. Ne e kemi bërë këtë gjë për të marrë mbrapsht atë që humbëm me marrëveshjen e vitit 2009. Nuk e kërkuan grekët rishikimin e marrëveshjes. Nuk e kanë ata kusht, rishikimin e saj për përmirësimin e marrëdhënieve", tha Rama.

"Deti", Shehu: Çështjen ta zgjidhim në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë

Deputeti i PD-së, njëherazi nënkryetari i Komisionit të Jashtëm, Tritan Shehu kritikoi dje palën shqiptare për negociatat me Greqinë, të cilat sipas tij janë mbyllur fshehurazi. Pas takimit me presidentin Meta, Shehu e konsideroi absurd nisjen e diskutimeve teknike, në një kohë që palët kanë rënë dakord politikisht. Pas takimit me presidentin Meta, Tritan Shehu, tha se gjithçka është bërë në mungesë transparence, duke iu referuar edhe deklaratave të ministrit të Jashtëm grek, i cili flet për një marrëveshje të përfunduar. "Negociatat deri tani janë nisur në mënyrë aspak transparente, aspak të qartë dhe pa plotfuqishmëri, dhe i kërkohet tani ditët e fundit. Jemi në një situatë ku mungon transparenca dhe ministri grek i Jashtëm thotë se marrëveshja është arritur, por pa plotfuqishmëri të presidentit tonë pa asnjë hap legal dhe asnjë nuk di mbi çfarë baze do ishte kjo marrëveshje",-tha z.Shehu. Ai shtoi se do të ishte e udhës që Greqia dhe Shqipëria t'i drejtohen Gjykatës Ndërkombëtare, teksa vlerësoi marrëveshjen e 2009 të bërë nga qeveria Berisha. "Ne gjykojmë dhe unë gjykoj që mënyra më racionale për të shtyrë përpara këtë proces, për të hequr të gjithë tymnajat për të qenë sa më i drejtë ky proces është që kjo marrëveshje, ose ky delimitim i kufijve detarë me Greqinë të zgjidhet nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Të dy vendet me mirëkuptim t'i drejtohen dhe pastaj në mirëkuptim të dy vendet të pranojnë verdiktin e tyre dhe konkluzionet e tyre. Unë gjykoj se ky do të ishte zgjidhja më e mirë për këtë problem artificial të krijuar nga kjo qeveri qoftë kundër marrëveshjes së 2009 që ishte një marrëveshje e mirë, qoftë për këtë mënyrë të shtrembër, jo transparente me të cilën është kjo periudhë deri më sot në negociatat me Greqinë për marrëveshjen e re",-tha deputeti i PD-së.



Sot Kosova 10 vjet shtet, arrin marrëveshjen për Demarkacionin me Malin e Zi

Thaçi nderon Ramën me Medaljen e Pavarësisë: Zë i fuqishëm mbështetës

Kryeministri: Pakti me Malin e Zi hap lëvizjen e lirë

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama u nderua dje, me Medaljen presidenciale të Pavarësisë nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Medalja iu dorëzua Kryeministrit Rama në një ceremoni të veçantë Prishtinë nga Presidenti Thaçi, në prag të kremtimit të 10-vjetorit të Pavarësisë, për "kontributin e dhënë për lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës". "Sot pata nderin dhe kënaqësinë, me autoritetin tim kushtetues dhe ligjor të ndaj Medaljen Presidenciale me rastin e 10-vjetorit të Pavarësisë për Kryeministrin e Shqipërisë, për kontributin e tij në lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, duke çmuar dhe respektuar shumë angazhimet e konsolidueshme në proceset më të vështira që ka kaluar vendi. Zëri i Edit ka qenë i fuqishëm në mbështetje të lirisë së Kosovës, në mbështetje të shtetndërtimit, konsolidimit dhe të integrimit sa më të shpejtë të Kosovës në NATO dhe në Bashkimin Europian,"-u shpreh ndër të tjera Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi.

Mirënjohës për këtë vlerësim të lartë, Kryeministri Rama u shpreh se "është një nga momentet më emocionuese dhe një nder i jashtëzakonshëm. Dua t'ju shpreh të gjithë mirënjohjen time, juve personalisht dhe dua të falënderoj Kosovën për këtë emocion kaq të paharrueshëm!". Kryeministri Rama, gjithashtu, përgëzoi Kosovën për finalizimin e Marrëveshjes së Demarkacionit me Malin e Zi, duke e konsideruar këtë si një hap të rëndësishëm drejt integrimit të mëtejshëm europian të Kosovës. "Zoti President, unë dua t'ju përgëzoj për atë që ju bëtë, së bashku me Presidentin e Malit të Zi, si një hap i vendosur drejt finalizimit të një procesi që, uroj dhe shpresoj do të mbyllet në këtë moment historik të përvjetorit të 10-të të Pavarësisë, për t'i hapur rrugën përfundimisht Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, që si të gjithë të tjerët të lëvizin lirisht, por jo vetëm për këtë, por edhe për të dëshmuar seriozitet dhe përkushtim nga shteti i Kosovës në arenën ndërkombëtare, si një shtet që di të bëjë marrëveshje dhe di të respektojë marrëveshje,"-deklaroi Kryeministri Rama.

MARRËVESHJA

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe homologu i tij nga Mali i Zi, Filip Vujanoviç nënshkruan dje, një marrëveshje të përbashkët për t'i hapur rrugë ratifikimit të Marrëveshjes për Demarkacionin me Malin e Zi, të nënshkruar në vitin 2015. Në një konferencë për shtyp, presidenti Thaçi theksoi se "me domosdoshmërinë e lëvizjes sa më të shpejtë të perspektivës evropiane dhe fuqizimit të fqinjësisë së mirë dhe domosdoshmërisë për ratifikim duke vlerësuar dhe vullnetin e mirë të Malit të Zi dua të shpalos para jush që në 48 orët e fundit unë si President dhe Presidenti i Malit të Zi nxorëm një deklaratë të përbashkët që i inkurajojmë Kuvendin e Kosovës ta ratifikojë marrëveshjen për kufirin". Republika e Kosovës dhe Malit të Zi me vullnet të mirë duke respektuar fqinjësinë e mirë, sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë e të dy shteteve, me respektimin e parimit pacta sunt servanda pajtohen si në vijim: "Republika e Kosovës do të procedojë në Kuvendin e Kosovës dhe do të ofrojë të gjitha përpjekjet për të ratifikuar marrëveshjen sipas nenit 12 të Marrëveshjes. Republika e Kosovës dhe Mali i Zi pas ratifikimit njoftojnë njëratjetrën që kanë përmbushur procedurat e tyre të brendshme ligjore përmes kanaleve diplomatike dhe konstatohet se marrëveshja që ka hyrë në fuqi do të formojë një trup të përbashkët punues për shënjimin e vijës kufitare".

LULZIM BASHA

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha përshëndeti dje, arritjen e marrëveshjes mes presidentëve të Kosovës dhe Malit të Zi për demarkacionin. "Në këtë përvjetor të dhjetë të Pavarësisë ky është një lajm i mirë për Kosovën. Marrëveshja është një akt i qartë i bashkërendimit të Kosovës me aleatët tanë euroatlantikë", - tha dje, Basha. "Shpreh bindjen se votimi i saj në parlamentin e Kosovës meriton vlerësimin e duhur nga institucionet europiane dhe se do të shpejtojë hapat e Kosovës drejt integrimit europian",-u shpreh ai.

MINISTRIA E JASHTME

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme mirëpret hapin e hedhur mes Kosovës dhe Malit të Zi, drejt përfundimit të demarkacionit të kufirit mes dy vendeve dhe e konsideron atë si dëshmi konkrete të vullnetit të të dyja vendeve për të forcuar marrëdhëniet dhe për të kontribuar në mënyrë thelbësore në forcimin e stabilitetit dhe bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor.

Presidenti merr pjesë në pritjen për Pavarësinë

Ilir Meta: Kosova tashmë një shtet me të ardhme europiane

Presidenti i Republikës, Ilir Meta mori pjesë dje, në pritjen e organizuar nga ambasada e Kosovës me rastin e 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Gjatë fjalës përshëndetëse, Meta vlerësoi progresin e jashtëzakonshëm që ka bërë Kosova në këto 10 vjet dhe kthimin në një faktor stabiliteti për rajonin. Duke vlerësuar edhe marrëveshjen e demarkacionit mes Kosovës e Malit të Zi, Meta tha: "Sot festojmë 10-vjetorin e shtetit të Kosovës, shtetit më të ri të Europës, të një shteti që ka bërë një progres të jashtëzakonshëm në këto 10 vite dhe të një shteti që ka padyshim një të ardhme akoma më të fortë europiane pas

mëngjesit të sotëm dhe deklaratës së presidentit Thaçi dhe atij të Malit të Zi Vujanoviç për zgjidhjen e çështjes së Demarkacionit, e cila do ta përshpejtojë perspektivën europiane të Kosovës dhe liberalizimin e vizave për të gjithë qytetarët e saj. Kemi shumë arsye për të festuar, për të gëzuar për këtë sukses të jashtëzakonshëm, për këtë arritje të madhe të popullit të Kosovës, të qytetarëve të Kosovës dhe të shtetit të Kosovës që rritet dhe forcohet çdo ditë si faktor stabilitetit në rajon. Kemi shumë arsye sot për t'u përkulur me nderim përpara veprës dhe vizionit të Presidentit të përjetshëm të Kosovës, Ibrahim Rugova, përpara sakrificave sublime të Adem Jasharit dhe të gjithë atyre që u sakrifikuan për lirinë e Kosovës". Ai falënderoi aleatët duke filluar me SHBA. "Gjërat kanë ndryshuar shumë pavarësisht se asnjëherë nuk kënaqemi me arritjet dhe kjo është pozitive sepse synojmë arritjen më pozitive. Ndaj, i uroj suksese të tjera shtetit të Kosovës, popullit të Kosovës, qytetarëve të Kosovës!",-tha në fund Meta.

Haradinaj sulmon hapur Ramën: Merru me Shqipërinë, se ke shpikje që të dalin boll

Kryeministri Ramush Haradinaj nuk i ka kursyer akuzat e drejtpërdrejta për homologun e tij shqiptar Edi Rama. Këtë e ka bërë përmes një postimi në "Facebook", ku i ka sugjeruar kryeministrit Edi Rama që të merret me punët e Shqipërisë dhe jo të Kosovës. Madje Haradinaj thekson se Rama ka shumë 'shpikje' me të cilat duhet të merret në Shqipëri. "Urime pavarësia e Kosovës të gjithë shqiptarëve. Edi Rama nuk ka çfarë të flasë për shpikjet politike në Kosovë! Le të merret me shpikjet e veta brenda Shqipërisë se i dalin boll", - shkruan Haradinaj.

Policia: Dyshohet për konflikt të çastit ose për shkak të kaluarës së Gjon Pelivanit

Plagoset rivali i Shullazit, shpallen në kërkim babë e bir

Plumbat kapën rastësisht dhe kamerierin e lokalit

Ina Allkanjari

Dy persona mbetën të plagosur me armë zjarri mesditën e djeshme në kryeqytet, pas një konflikti në një lokal në zonën e Selitës. Bëhet me dije se ka mbetur i plagosur 27 vjeçari Gjon Pelivani dhe kamerieri, 31-vjeçari Renato Hoxha. Të dy të plagosurit kanë marrë plagë në këmbë dhe janë shoqëruar menjëherë në drejtim të spitalit të traumës, ku mësohet se janë jashtë rrezikut për jetën. Dyshohet se ngjarja ka ndodhur pas një konflikti që Gjoni ka pasur me pronarin e lokalit Florian Musain. Në sherr e sipër është afruar edhe djali i tij, Arti Musai, i cili ka qëlluar drejt 27-vjeçarit duke e lënë të plagosur. Mendohet se shënjestra ka qenë Gjon Pelivani, ndërsa 31-vjeçari Hoxha dyshohet se është plagosur rastësisht. 27-vjeçari rezulton me dy emra pasi njihet edhe si Valment Pelivani, emër me të cilin rezulton të ketë një të shkuar kriminale. Sakaq policia ka shpallur në kërkim babë e bir, si autorë të ngjarjes.

NGJARJA

Mesditën e djeshme rreth orës 12:30, në rrugën "Irfan Tomini", gjatë një konflikti të çastit u plagosën me armë zjarri në këmbë shtetasit Renato Hoxha, 31 vjeç dhe Gjon Pelivani 27 vjeç. Shërbimet e policisë kanë shkuar në kohë në vendngjarje ku kanë bërë identifikimin e autorit dhe po punohet intensivisht për kapjen e tij. Policia është vënë të kërkim të Florian Musait dhe djalit të tij, Arti Musai, i cili dyshohet të jetë autori i plagosjes. Paraprakisht thuhet se personat janë përfshirë në një sherr brenda një lokali, e më pas kanë dal jashtë ambienteve të lokalit ku janë konfliktuar deri në përdorimin e armëve. Gjon Pelivani ishte konfliktuar me pronarin e lokalit Florjan Musain. Në sherr e sipër është afruar edhe djali i Florjan Musait, Arti Musai. Ky i fundit ka qëlluar drejt Gjon Pelivanit disa herë, duke e lënë të plagosur. Nga të shtënat ka mbetur i plagosur aksidentalisht edhe kamerieri i lokalit. Në këtë vend ekspertët kanë gjetur një gëzhojë, çka shton dyshimet se autori ka qëlluar edhe pasi ka qenë duke u larguar me vrap. Në shënjestër të të shtënave ishte Gjon Pelivani. Sipas burimeve nga policia, bëhet e ditur se autori ishte i veshur me xhup të zi dhe mbante kapele në kokë. Ndërkohë, forcat blu kanë shoqëruar në komisariat disa nga qytetarët dëshmitarë të cilët janë marrë në pyetje, duke dhënë edhe një përshkrim të autorit. Por, nga ana tjetër, i gjithë ky moment është filmuar nga kamerat e sigurisë, që pritet të hedhin dritë mbi ngjarjen.

I plagosuri, Gjon Pelivani

PLAGOSJA

Dyshohet se ngjarja ka ndodhur pas një konflikti që Gjoni ka pasur me pronarin e lokalit Florian Musain. Në sherr e sipër është afruar edhe djali i tij, Arti Musai, i cili ka qëlluar drejt 27-vjeçarit duke e lënë të plagosur. Mendohet se shënjestra ka qenë Gjon Pelivani, ndërsa 31-vjeçari Hoxha dyshohet se është plagosur rastësisht.

E SHKUARA E GJON PELIVANIT

Policia dyshon se shkak i ngjarjes së rëndë mund të jetë një konflikt i çastit, por nuk përjashtohet pista e konflikteve të vjetra të Gjon Pelivanit. Nga verifikimet e kryera, i riu rezulton person me precedentë penale. 27-vjeçari ka qenë i dënuar më parë për vjedhje. Ndërsa në vitin 2015, Pelivani, atëherë 24-vjeç, është plagosur me armë zjarri nga Gilmando Dani, shok i Emiljano Shullazit. Pelivani ka pasur konflikte me grupin e Shullazit, të cilat kanë arritur deri në përdorimin e armëve të zjarrit. Nuk dihet nëse ngjarja e sotme ka lidhje me të shkuarën e tij të errët. Gjithashtu Valment Pelivani është hetuar dhe për plagosjen e policit Ermal Bregu, ngjarje kjo e ndodhur te ish-Parku i autobusëve në dhjetor 2017. Edhe pse është marrë në pyetje, Pelivani është lënë i lirë për mungesë provash.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të kolegjit të Posacëm të Apelimit":

I - Rishpall vendet vakante për pozicionet:

1. Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marëdhënieve me Median dhe Publikun

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Drejtësi.
b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

2. Drejtor në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Ekonomi.
b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

3. Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

a. Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Degën Gjuhë -Letërsi.
b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

4. Specialist IT

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
b. Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
c. Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory,Outlook Mail Client
d. Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastukturën e rrjetit.
e. Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve ëeb (Ëordpress, Drupal, Joomla etj).
f. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Çertifikate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 26 Shkurt deri më 28 Shkurt 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "**Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë**. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës **28 Shkurt 2018**, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- **Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike** nga data **26 Shkurt deri më 28 Shkurt 2018** në adresën: **info@kpa.al.** KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat qe janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Policia: Identifikohen personat që Memli Begalla iu kishte rreth 90 mijë euro borxh

Vrasja e biznesmenit, me kapele dhe xhaketë të bardhë, kamera filmoi ekzekutorin

Ekspertët: Dyshohet për vrasës me pagesë

Vijonë hetimet për vrasjen e biznesmenit, Memli Begalla tri ditë më parë në kryeqytet. Kamerat e sigurisë të sekuestruara ditën e atentatit nga policia, kanë mundur të fiksojnë ekzekutorin e biznesmenit 64-vjeçar. Sipas ekspertëve duke u nisur nga mënyra se si ka vepruar vrasësi dhe lëvizjet që ka bërë, dyshohet që atentatori mund të jetë një person i paguar. Nga kamerat e sigurisë në Rr. Nikolla Tupe, ku ndodhi edhe ngjarja, autori mban veshur një xhaketë të bardhë, të mbërthyer deri te buzët. Në kokë ka një kapele, e cila nuk lejon që t'i duket fytyra. Pasi ka qëlluar mbi biznesmenit, ai dallohet duke ecur me hapa të lehtë, pa rënë në sy. Fillimisht ecën në këmbë, e më pas e ndihmon një makinë për t'u larguar te sheshi "Willson".

VRASJA

Sipas burimeve pranë grupit hetimor, Memli Begalla që kishte aktivitet në fushën e turizmit, energjetikës, ndërtimit dhe import-eksport të industrisë ushqimore është qëlluar sapo ka dalë nga automjeti i tij. 64-vjeçari është qëlluar me një plumb në kokë nga autorët dhe për pasojë ka mbetur i vdekur në vend. Burimet e mësipërme pohuan se autorët e kanë ndjekur biznesmenin me një makinë tip "BMW" me ngjyrë të zezë dhe me xhama të zinj dhe pasi kanë qëlluar mbi objektivin janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes. Ndërkaq, dyshohet se viktima i ka pikasur autorët dhe ka dalë nga makina e tij për të shpëtuar. Shkak për këtë ngjarje dyshohet të jenë konfliktet për shkak të borxheve të shumta. Afrim Begalla, cili ka ndërruar emrin në Memli Begalla rezulton që t'u ketë shumë personave borxh në shuma të mëdha eurosh dhe lekësh, madje me disa prej tyre ishte ende në procese gjyqësore. Policia raportoi të jenë identifikuar personat që 64-vjaçari iu kishte borxh rreth 90 mijë euro. Ata u shoqëruan në polici, por mohuan të kenë lidhje me vrasjen. Ndërkohë që ky mund të cilësohet edhe krim i paralajmëruar, pasi rreth 3 vite me parë Begajt në po të njëjtin vend, ku u ekzekutua iu dogj qëllimisht automjeti i tij 'Land Rover' që kishte në përdorim.

Viktima, Memli Begalla

Autori

KAMERAT E SIGURISË

Nga kamerat e sigurisë në Rr. Nikolla Tupe, ku ndodhi edhe ngjarja, autori mban veshur një xhaketë të bardhë, të mbërthyer deri te buzët. Në kokë ka një kapele, e cila nuk lejon që t'i duket fytyra. Pasi ka qëlluar mbi biznesmenit, ai dallohet duke ecur me hapa të lehtë, pa rënë në sy.

KUSH ËSHTË BIZNESMENI I EKZEKUTUAR NË ZONËN E ISH-BLLOKUT

64-vjeçari Memli Begalla me origjinë nga fshati Progonat I Tepelenës ka qenë sipërmarrës dhe ka 2 agjenci pranë kullave binjake. Ai ka jetuar në Zvicër dhe ka pasur probleme në të kaluarën. Begalla ishte administrator i kompanisë LAB-AB. Objekti i veprimtarisë së firmës së tij janë: Aktivitet në fushën e turizmit, energjetikës, ndërtimit, import eksport, prodhim dhe eksport të industrisë ushqimorë etj. Gjithashtu, 64-vjeçari ka në pronësi dy gomisteri në zonën e Yzberishtit dhe në autostradën Tiranë-Durrës, si dhe një agjenci turistike, që administrohet nga vajza e tij.

bashkëpunimi gjerman DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by giz

OPEN CALL FOR TENDER

PREQUALIFICATION

1. GENERAL CONDITIONS

1.1. Requester: Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej, No. 21/1

1.2. Profile: German Development Cooperation , Office in Tirana supports Albania on its path to European integration and development through projects implemented in : Economic development, Economic legal reform, Vocational education and training, Reform of the water sector, Rural development, and some other areas

1.3. **Subject:** The GIZ Office Tirana invites qualified companies to express their interest in providing **Professional translation services from and to Albanian, German and English, for the needs of GIZ Office Albania**. All legal entities interested in application process should ask for an application form to the address: giz-albanien@giz.de

2. The **due date** for submitting the application is **26 February 2018**. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: Professional translation services", addressed to:

German Development Cooperation Office (GIZ), Office in Tirana,
Rr. Skenderbeg, No. 21/1
Tirane

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow.

The submitted applications will be evaluated, and only prequalified candidates will be invited to answer to the bid.

Iu sekuestruan 276.6 gramë lëndë e dyshuar narkotike Kokainë

Shisnin drogë në zonën e ish-Bllokut, arrestohen në flagrancë 4 persona

Policia e Tiranës ka vënë në pranga ditën e djeshme katër persona, pasi shpërndanin lëndë narkotike të llojit kokainë në zonën e ish-Bllokut në kryeqytet. Specialistët për Hetimin e Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e rasteve të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike, kanë goditur një tjetër rast duke finalizuar me sukses operacionin e koduar "Decline". Janë arrestuar në flagrancë shtetasit Azis Meta, 35 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar për "Trafik armësh dhe lëndë narkotike"; Përparim Kalbaj, 46 vjeç, banues në Tiranë; Aleks Kanaçi, 35 vjeç, banues në Berat; E.B, 23 vjeçe, banuese në Tiranë. Bëhet me dije se këta shtetas në bashkëpunim me njëritjetrin, kryenin aktivitetin e kundërligjshëm të shitjes së lëndëve narkotike të dyshuar të llojit "Kokainë" në sasi të vogla personave të ndryshëm në zonën e "Bllokut". Shtetasit e lartpërmendur lëviznin me dy automjete. Gjatë kontrollit fizik shtetasve të mësipërm iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale: 276.6 gramë lëndë e dyshuar narkotike e llojit "Kokainë". Gjithashtu, janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale 2 automjete dhe 7 telefona celularë.

Ardi Veliu prezanton drejtorin e ri të policisë Tiranë: Ka treguar integritet dhe profesionalizëm

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Ardi Veliu prezantoi ditën e djeshme Kastriot Skënderaj, në detyrën e Drejtorit të Policisë Vendore Tiranë. Veliu ka vlerësuar integritetin dhe profesionalizmin e treguar nga Skënderaj në detyrat e mëparshme dhe shprehu bindjen se edhe në këtë detyrë shumë të rëndësishme do ta përmbushë me sukses. Drejtori i Përgjithshëm falënderoi efektivët e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë për përkushtimin që kanë treguar gjatë kohës që ai ishte në krye të policisë vendore dhe u kërkoi që rezultatet e arritura t'i rritin më tej, nën drejtimin e zotit Skënderaj. Drejtues i Parë Kastriot Skënderaj vjen nga një karrierë e gjatë policore në rolin drejtues, ku së fundi mbante postin e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Kufirit Tiranë.

Autorëve u gjenden 8 granata dore dhe kanabis

Terrorizuan banorët e Lezhës me armë zjarri, përfundojnë në pranga tre persona

LEZHË - Tre persona kanë përfunduar në pranga, pasi kanë terrorizuar banorët e Lezhës, duke qëlluar me armë zjarri në ajër. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se ngjarja ka ndodhur dy ditë më parë në lagjen "Varosh" të këtij qyteti. Të arrestuarit janë shtetasit Markelian Pepa, E.M., P.D., të cilët akuzohen dhe për një tjetër ngjarje të ndodhur në dhjetor të vitit kaluar. Mësohet se personave në fjalë u janë gjetur dhe sekuestruar armë, granata dore dhe kanabis sativa. Burimet e mësipërme pohuan se rreth orës 14:30 të së enjtes, 21-vjeçari Pepa, banues në Reps të Mirditës dhe dy 15-vjeçarët E.M. dhe P.D., banues në Lezhë kanë qëlluar me armë zjarri pranë hyrjes se një tuneli poshtë kalasë së qytetit, duke shkaktuar panik tek qytetarët. Falë reagimit të shpejtë dhe profesional të shërbimeve të Policisë së Lezhës, është bërë e mundur kapja dhe arrestimi i tyre në flagrancë.

PRECEDENTI
Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, dyshohet se këta shtetas në bashkëpunim me njëri-tjetrin janë dhe autorë të ngjarjes së datës 19.12.2017, ku rreth orës 19:00 kanë qëlluar me armë zjarri, në drejtim të banesës së shtetasit Xh.M., në lagjen "Besëlidhja" të qytetit të Lezhës.

Arma e sekuestruar nga policia

Grupi hetimor ka gjetur dhe sekuestruar në vendngjarje 35 gëzhoja. Në vijim të veprimeve të kryera, blutë kanë bërë të mundur gjetjen e armës (pushkë model 56), me të cilën kishin qëlluar shtetasit e sipërpërmendur, të cilën e kishin fshehur në shkurre përreth zonës ku kishin qëlluar. Së bashku me armën, grupi hetimor ka gjetur dhe sekuestruar edhe 332 fishekë luftarakë dhe 8 granata dore dhe një pistoletë shenjë dhënëse. Po gjatë kontrollit, grupi hetimor ka gjetur dhe sekuestruar edhe një sasi të vogël lënde narkotike të llojit kanabis sativa. Materialet procedurale në ngarkim të tre të arrestuarve do t'i referohen Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për veprat penale: "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit", "Prishja e qetësisë publike" si dhe "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike" për të riun Markelian Pepa.

Gjykata e Tiranës e ka dënuar Alban Beshirin me 6 muaj burg për kanosje

Kërcënoi me SMS gjyqtaren pas divorcit, ekstradohet nga Anglia 36-vjeçari

"Do të vij në Shqipëri e do të të bëj për karrocë"

TIRANË

Një 36-vjeçar është ekstraduar nga Londra, pasi ishte shpallur në kërkim nga autoritetet shqiptare, ndërsa ishte dënuar me 6 muaj burg për kanosje të një gjyqtareje. Bëhet fjalë për shtetasin Alban Beshiri, lindur në Vorë, Tiranë. Burime zyrtare nga policia dje bënë me dije se ai e kërcënonte nga Anglia gjyqtaren Oltiana Çifligu se do të kthehej në Shqipëri dhe do e bënte për spital. 36-vjeçari u arrestua në Angli më 12 korrik të vitit 2016 pas një kërkese ekstradimi dërguar nga Interpol Tirana. Mësohet se Beshiri kishte fituar nënshtetësinë britanike dhe jetonte në qytetin Coventry. Duke qenë shtetas anglez, ai kishte dërguar disa letra Ministrisë së Jashtme britanike, ku pretendonte se nëse ekstradohej në Shqipëri, i kërcënohej jeta. Sipas burimeve policore, ekstradimi i Alban Beqirit u bë nga specialistët e Interpolit. Ai ishte shpallur në kërkim, pasi me vendimin penal nr. 3727, datë 30.10.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka dënuar këtë shtetas me 6 muaj burg për veprën penale 'Kanosje e gjyqtarit'. Nga data 18.07.2014 e në vijim, Alban Beshiri ka kërcënuar gjyqtaren O.Ç., e cila po shqyrtonte çështjen gjyqësore ndaj tij, ku ai ishte i akuzuar për veprën penale "Dhunë në familje", duke e telefonuar dhe duke i dërguar mesazhe telefonike me përmbajtje kërcënuese. Si rezultat i bashkëpunimit të Interpol Tiranës me Interpol Mançester, u bë i mundur arrestimi i tij në Londër, duke u finalizuar me ekstradimin e tij drejt vendit tonë", thuhej në njoftimin zyrtar të policisë. E gjithë ngjarja nisi pasi 36-vjeçari u nda nga gruaja për dhunë në familje. Pas divorcit, ai ka vijuar shantazhet dhe kërcënimet ndaj ish-gruas, por edhe gjyqtares. Me anë të telefonit, ai ka kërcënuar disa herë gjyqtaren Oltjana Çifligu. "Do të bëj për spital, do të bëj për karrocë", - mësohet t'i jetë drejtuar ai asaj, ngjarje e cila ka ndodhur katër vite më parë. Po të njëjtat burime thanë se 36-vjeçari që nga Anglia ka kërcënuar se do të kthehej në Shqipëri dhe do e keqtrajtonte gjyqtaren në atë mënyrë që nuk kishte spital që ta merrte në dorëzim. "...Do të kapi e zeza ty dhe atë gjyqtaren qorre... Me ty e kam më kollaj, pasi ta di shtëpinë dhe të njoh të dashurin dhe do tëtë bëj për karrocë...", thuhej në një nga mesazhet e tij.

36-vjeçari i eksatraduar, Alban Beshiri

ARRESTIMI
Alban Beshiri nga Vora u arrestua në Angli më 12 korrik të vitit 2016 pas një kërkese ekstradimi dërguar nga Interpol Tirana. Mësohet se ai kishte fituar nënshtetësinë britanike dhe jetonte në qytetin Coventry. Duke qenë shtetas anglez, Beshiri i kishte dërguar disa letra Ministrisë së Jashtme britanike, ku pretendonte se nëse ekstradohej në Shqipëri, i kërcënohej jeta.

Shkatërrohet banda e drogës me në krye shqiptarin, arrestohen 7 persona

GREQI - Policia greke ka bërë të mundur shkatërrimin e një grupi kriminal, i cili akuzohet për trafik droge. Autoritetet helene arrestuan 7 persona, ku 4 prej tyre janë shqiptarë. Sipas mediave greke, shqiptarët e arrestuar janë: Renado Hodallari 27 vjeç, Spartak Zene 31 vjeç, Fatjon Habibaj 33 vjeç dhe Devis Nikolli 24 vjeç. Ky grup kriminal e ushtronte veprimtarinë e tij në zonën e Atikës, ndërsa drejtohej nga 27-vjeçari shqiptar Renado Hodallari. Mësohet se rol të rëndësishëm kishin edhe dy shqiptarë të tjerë. Anëtarët e bandës e fshihnin lëndën narkotike në banesat e marra me qira, duke vëzhguar edhe lëvizjet e kontrolleve të policisë.

SHKURT

Gjendet trupi i pajetë, dyshime për ish-punëtorin e mirëmbajtjes së rrugëve

PUKË - Një trup i pajetë është gjetur nga banorët në fshatin Lajthizë të Fushë-Arrëzit. Dyshimet e para janë se trupi i përket ish-punonjësit të mirëmbajtjes së rrugëve, Idriz Ahmetaj, i cili u zhduk tre muaj më parë pa asnjë gjurmë. Kanë qenë banorë të zonës, të cilët kanë gjetur trupin jo shumë larg fshatit, në zonën e Ujit të Ftohtë. Familjarët kanë shprehur bindjen se ai është i afërmi i tyre. Kjo, nisur dhe nga ngjashmëria e rrobave. Ndërkohë që pritet konfirmimi nga policia, pasi trupi është totalisht i dekompozuar. Njëkohësisht do zbardhen edhe rrethanat që çuan në vdekjen e tij. 54-vjeçari humbi kontaktet me familjen teksa po kthehej pasdite në shtëpi bashkë me bashkëshorten. Ai ndaloi për nevoja personale, ndërsa gruaja vazhdoi rrugën dhe që nga ai moment humbi pa gjurmë.

Pallati i rrezikuar nga rrëshqitja e dherave, banorët hidhen në protestë

GJIROKASTËR - Banorët e pallatit 8-katësh në Gjirokastër, që rrezikoi shembjen pas rrëshqitjeve të dheut dje janë hedhur në protestë. Ata u shprehën se prania e baltës ka shkaktuar lagështirë në banesat e tyre dhe askush nuk u ka ofruar një zgjidhje korrekte. "Nuk jetohet më në banesat tona, që janë gjithë baltë e lagështirë. Duhet të merren masa urgjente për zgjidhjen e këtij problemi", thanë banorët. Vetëm pak ditë më parë nisi aksioni për heqjen e baltës nga pallati 8-katësh në lagjen "Kodra e Shtufit". Në këtë operacion të ndërmarrë është ngarkuar ushtria, e cila do të heqë dherat nga pallati, në të cilin u shkaktuan shumë dëme materiale.

Sekuestrohen 336 kg marijuanë, kapen 2 shqiptarë e 1 italian

ITALI - Dy shqiptarë dhe 1 italian janë arrestuar në komunën Fraskati në Romë pas një operacioni, nga i cili u sekuestruan 336 kg marijuanë. Shqiptarët, njëri 26 e tjetri 22 vjeç furnizonin tregjet e drogës në provincën e Romës. Mësohet se tre personat u arrestuan në flagrancë, ndërsa po shkëmbenin drogën në një parking në zonën Prenestina. Në automjetin tip "Fiat Multipla" të 22-vjeçarit u sekuestruan 173 kg marijuanë e konfeksionuar në 13 pako të mëdha. Ndërsa, në banesën e 26-vjeçarit shqiptar u gjetën dhe 14 pako të tjera marijuanë në peshë 188 kg. Dy shtetasit shqiptarë të arrestuar ishin të skeduar më parë nga policia italiane për vepra të vogla penale.

Hyn në fuqi buxheti afatmesëm, qeveria ndan fondet për pronarët dhe ish-të dënuarit

Kompensimi i pronave, 13.6 miliardë lekë për tre vjet

Ish-të përndjekurit politikë, fondi i dëmshpërblimit 6. 5 miliardë lekë

Ornela Manjani

Fondi për kompensimin e pronarëve do të rritet progresivisht në tri vitet e ardhshme. Shuma në total për tri vite do të jetë 13. 6 miliardë lekë, përkatësisht për vitin 2018 fondi është 3.4 miliardë lekë, për vitin 2019 4.9 miliardë lekë dhe për vitin 2020, fondi 5.3 miliardë lekë. Shifrat janë bërë të ditura në buxhetin afatmesëm të ndryshuar, i cili është botuar dje në Fletoren Zyrtare. Edhe pse me ndryshimet e fundit ligjore ka marrë përparësi kompensimi fizik i pronave fondet për kompensimin financuar vijnë çdo vit në rritje. Sipas ligjit në fuqi, për efekt të kompensimit dhe të ekzekutimit të vendimeve përfundimtare, vlerëson financiarisht vendimet, duke u bazuar në vlerat e përcaktuara në hartën e vlerës dhe procedon si më poshtë vijon: a) Vlerëson financiarisht pronën e njohur për kompensim, në bazë të zërit kadastral që ka pasur prona në kohën e shpronësimit, duke u bazuar në hartën e vlerës. b) Vlerëson financiarisht pronën e kthyer, të kompensuar fizikisht apo të përfituar në një nga mënyrat e tjera sipas legjislacionit për kthimin dhe kompensimin e pronave, duke përcaktuar diferencën që do të rezultojë ndërmjet vlerës së saj sipas zërit kadastral aktual dhe vlerës së kësaj prone sipas zërit kadastral në kohën e shpronësimit. ç) Për vendimet që kanë njohur vetëm të drejtën për kompensim, vlerësimi do të bëhet në bazë të zërit kadastral që ka pasur prona në kohën e shpronësimit, sipas shkronjës "a", më sipër. d) Zëri kadastral i origjinës së pronës përcaktohet duke u bazuar në dokumentacionin ligjor të administruar në dosje ose, në mungesë të këtij të fundit, për përcaktimin e zërit kadastral do të përdoret harta e kohës së shpronësimit dhe në mungesë të saj, harta që është më e afërt me kohën e shpronësimit, në pamundësi objektive për përcaktimin e zërit kadastral, sipas kësaj shkronje, atëherë vendimi i kompensimit vlerësohet financiarisht me çmimin minimal, të përcaktuar në hartën e vlerës për atë njësi administrative dhe për atë kategori prone. dh) Në rastet kur në hartën e vlerës mungon vlera e caktuar për zërin kadastral të origjinës, vlerësimi financiar i vendimit përfundimtar që ka njohur të drejtën e kompensimit bëhet duke marrë si referim vlera me të njëjtin zë kadastral, që ndodhet më afër pronës që do të kompensohet. Në rast se pranë pronës që do të kompensohet gjenden disa zëra kadastralë të njëjtë me atë të origjinës së pronës, me distancë të njëjtë dhe me vlera të ndryshme, atëherë për referim në përllogaritje merret zona që ka çmimin më të lartë.

KOMPENSIMI I PRONARËVE

- Viti 2018, 3. 4 miliardë lekë
- Viti 2019, 4. 9 miliardë lekë
- Viti 2020, 5. 3 miliardë lekë

DËMSHPËRBLIMI I ISH-TË PËRNDJEKURIT

- Viti 2018, 2 miliardë lekë
- Viti 2019, 2 miliardë lekë
- Viti 2020, 2. 5 miliardë lekë

ISH - TË PËRNDJEKURIT

Në buxhetin afatmesëm për tre vjet është vënë në dispozicion të ish-të përndjekurve një fond prej 6.5 miliardë lekësh. Kështu, për vitet 2018 dhe 2019 fondi është nga 2 miliardë lekë për secilin vit, ndërsa për vitin 2020 shuma për dëmshpërblim është 2.5 miliardë leke. Pagesat për kategorinë parësore, ish-të dënuarit politikë që janë mbi 75 vjeç, thuajse janë mbyllur pasi është paguar edhe kësti i tetë dhe i fundit. Ndërsa shumat e vëna në dispozicion për vitet e ardhshme do të shkojnë për kategorinë parësore në masën 70% të fondit. Sipas urdhrit të Ministrisë së Financave në kategorinë e dytë me prioritet janë persona ish-të dënuar mbi 75 vjeç në datën e hyrjes në fuqi të ligjit që vazhdojnë të jenë gjallë. Kjo kategori duhet të paraqesë certifikatë personale jo më e vjetër sesa një javë nga data e dorëzimit dhe numrin e llogarisë. Ndërsa në kategorinë e tretë me prioritet janë persona ish-të dënuar politikë të gjallë që vuajnë nga sëmundje të rënda. Kjo kategori duhet të paraqesë raport mjeko- ligjor, origjinal me emra dhe mbiemra të anëtarëve me firmë të gjithsecilit dhe me vulë, jo kopje) për paaftësi të plotë për punë e lëshuar nga KEMCAP, raport mjekoligjor për sëmundje onkologjike dhe sëmundje të gjakut të pashërueshme të lëshuar nga: Qendra Shëndetësore Universitare "Nënë Tereza", Qendra Shëndetësore Universitare "Shefqet Ndroqi", certifikatë personale dhe numrin e llogarisë bankare në lek. Për kategorinë e katërt me prioritet kanë për persona ish- të dënuar që janë gjallë, të cilët pavarësisht, moshës në momentin e pagesës kanë fëmijë të mitur nën moshën 18 vjeç. Përfituesit e kësaj kategorie duhet të paraqesin certifikatë personale jo më e vjetër se një javë nga data e dorëzimit, certifikatë familjare ku të përfshihet fëmija i mitur, certifikatë personale të fëmijës/fëmijëve të mitur dhe numër llogarie bankare në lek. Ndërsa për kategorinë e pestë me prioritet, "Për persona ish-të dënuar që nuk jetojnë, por në momentin e pagesës kanë trashëgimtarë të radhës së parë në moshë të mitur nën 18 vjeç". Përfituesit duhet të paraqesin certifikatë vdekjeje të personit ish-të dënuar, certifikatë personale e të miturit/miturve, trashëgimtarë të radhës së parë të personit ish-të dënuar që nuk jeton më, certifikatë familjare të ish-të dënuarit ku të përfshihen fëmija/fëmijët e mitur, dëshmi trashëgimie që të vërtetojë se fëmija i mitur është trashëgimtar ligjor. Vendim gjykate të kujdestarisë mbi të miturin në rastin kur edhe nëna e të miturit nuk jeton më dhe numër llogarie bankare. Për kategorinë e gjashtë me prioritet, "Për persona ish-të dënuar që janë gjallë dhe në momentin e pagesës nuk kanë mbushur 75 vjeç", të cilët duhet të dorëzojnë certifikatë personale jo më e vjetër se një javë nga data e dorëzimit dhe numër llogarie. Në kategorinë joparësore ku janë trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, të cilët presin të marrin këstin e parë të dytë ose të tretë, fondet do të jenë 30% të vlerës së përgjithshme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Me vendimin nr. 31, datë 09.02.2018, Bordi i ERE ka vendosur "Fillimin e procedurës për miratimin e rregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror."

Të gjithë personat, shoqatat, institucionet, që mendojnë se kanë interes mbi këtë çështje, ftohen të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga dita e publikimit të njoftimit.
Draftin e Rregullave sipërcituar, mund ta gjeni në faqen tonë të web-it: www.ere.gov.al në seksionin Konsultime.

KRYETARI
Petrit AHMETI

Adresa:Bulevardi "Barjam Curri"
Rruga. Viktor Eftimiu,Tirane
E-mail erealb@ere.gov.al
Tel/Fax +355 42 22 963
Tel +355 42 69 590
www.ere.gov.al

REPUBLIKA SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT DURRES

Shpallje për vend të lirë punë për specialist IT pranë Gjykatës së Apelit Durrës
Kushtet qe duhet të plotësojë kandidati:

- të jenë diplomuar në shkencat teknologji e informacionit, të paktën në nivelin "Master shkencor" ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;
- të kenë kryer të paktën një vit praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën;
- përbëjnë avantazh kualifikime në fushën e kërkuar dhe punësimi i mëparëshëm në administratë gjyqësore;
- Të ketë njohuri të mira në gjuhë të huaja, sidomos gjuhës angleze;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të bashkëpunimit në grup;

Dokumentacioni dhe afati i dorëzimit:
Kandidati të paraqesë brenda datës **26/02/2018** në Gjykatën e Apelit Durrës në adresën Lagja Nr.14, Shkozet Durrës, këto dokumenta:

- Kërkesë për aplikim;
- CV të përshkrimit të karrierës;
- Fotokopje të diplomës dhe librezës së notave (e noterizuar);
- Fotokopje të librezës së punës (e noterizuar);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimeve (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmive të gjuhëve të huaja (nëse ka);
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Çertifikatë personale.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell s'kualifikim të kandidatit.
Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentacioni pranë Gjykatës së Apelit Durrës **jo më vonë se data 26/02/2018**.;Pas verifikimit paraprak të aplikimeve, vetëm aplikantët që kualifikohen për intervistë do të kontaktohen.

Ende asnjë reagim nga Ministria e Shëndetësisë

Mungesë ilaçesh për fëmijët me kancer

Fëmijët e prekur nga sëmundjet tumorale, nuk mund të kurohen plotësisht pasi ka mungesë medikamentesh. Ditën e djeshme, "Gazeta Shqiptare" ngriti alarmin në lidhje me problemin e mprehtë, por ende nuk ka pasur një reagim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndërkohë që jeta e vogëlushëve mund të

jetë në rrezik. Sipas të dhënave, mesatarisht në një vit ka rreth 30 raste të reja me leucemi akute si dhe 40-50 raste me tumore të ngurta që shfaqen te fëmijët. "Problemi i citostatikëve (medikamentet kryesore për terapinë e neoplazive) ka qenë dhe mbetet një problem i mprehtë për gjithë strukturat shëndetësore të përfshira në luftën kundër kancerit. Ka qenë e mbetet problem për zgjidhje për tërë qeveritë, pavarësisht ngjyrave. Bëhet fjalë për medikamente të shtrenjta, për të cilët nevojitet një buxhet mjaft ambicioz. Ndërkohë, ne jemi në gjendje, në përgjithësi, të aplikojmë e plotësojmë skemat europiane të terapisë, që premtojnë shifra më të larta shërimi. Mbetet një sfidë e mprehtë. Gjatë vitit 2017 furnizimi ishte më i mirë se një vit më parë, por përsëri, në periudha të ndryshme, kemi pasur mungesë medikamentesh të ndryshme. Duhen gjetur rrugët që asnjë pacient i shtruar në spital të mos gjendet i detyruar të blejë privatisht medikamente, apo edhe të bëjë në struktura private ekzaminime të domosdoshme për diagnozë",-tha shefja e Shërbimit të Onkohematologjisë në QSUT, Anila Godo në intervistën e dhënë për Gazeta Shqiptare.

Zv.ministrja Kospiri: Sistemi garanton transparencë, kanë përfituar edhe abuzuesit

Përplasje për skemën e re të ndihmës ekonomike

Vokshi: Janë lënë jashtë 20 mijë familje

Voltiza Duro

Të gjithë ata që kanë abuzuar me ndihmën ekonomike, janë lënë jashtë skemës pas verifikimeve që po kryhen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këto ndryshime, të testuara fillimisht në 3 qarqe të planifikuara më pas në të gjithë vendin, u shoqëruan me protesta të shumta nga ana e personave që humbën të drejtën e përfitimit. Ditën e djeshme zv.ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bardhylka Kospiri ka sqaruar se skema e re garanton që ndihma ekonomike të shkojë te ato familje që me të vërtetë kanë nevojë pasi ky sistem është transparent e eliminon abuzimet. "Kjo skemë e re garanton që pagesa e ndihmës ekonomike shkon tek familjet më në nevojë. Për herë të parë kanë pasur mundësi aplikimi 18 mijë aplikues, të cilët deri dje përjashtoheshin për shkak të kritereve përjashtuese të skemës së vjetër. Skema funksionon përmes regjistrit elektronik, i cili duke qenë i lidhur me të gjitha sistemet online, nxjerr jashtë abuzuesit",-tha Kospiri në fjalën e saj. Kjo e fundit theksoi se shumë abuzues kanë përfituar ndihmë ekonomike në kurriz të atyre që ishin më në nevojë, por sipas saj sot, fondet shkojnë te individët që plotësojnë kriteret. Zv.ministrja nuk la pa përmendur edhe disa raste abuzive ku përfitonin ndihmë edhe individë që kishin 4 makina apo pagë 1.5 milionë lekë. Skema e re ka hequr ndihmën ekonomike të pjesshme dhe tashmë mund të merret vetëm e plotë, duke verifikuar derë më derë familjet që përfitojnë. Kospiri shtoi se të gjithë ata që nuk mundën të merrnin ndihmë ekonomike, mund të paraqiten sa më parë në bashki, pasi një pjesë e fondit është në dispozicion për këtë kategori. "Nëpërmjet rivlerësimit këto familje rikthehen si pjesë e skemës duke aplikuar në bashkinë përkatëse, të gjitha bashkive u është dhënë 6 % e fondit për të mbështetur familjet që nuk plotësuan kriteret. Është nevojë të paraqiten menjëherë pranë bashkive që duhet të përdorin fondin e vënë në dispozicion në këto raste, fond i dyfishuar tashmë",-u shpreh zv.ministrja.

Zv.ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bardhylka Kospiri

Albana Vokshi deputete e PD-së

20

MIJË FAMILJE

Sipas deputetes së PD-së, Albana Vokshi janë rreth 20 mijë familje në mbarë vendin që kanë humbur të drejtën e përfitimit të ndihmës ekonomike. "Qeveria në mënyrë abuzive ka larguar nga skema e ndihmës rreth 15 mijë familje në Tiranë, 752 familje në Kamzë 682 në Kavajë, 752 familje në Lushnjë, 826 familje në Divjakë e mbi 2000 në Pogradec. Qeveria nuk shpjegon pse ka përjashtuar mijëra nëna kryefamiljare me fëmijë jetimë",-thekson Vokshi.

REAGIMET

Menjëherë pas miratimit të skemës së re të ndihmës ekonomike, opozita ka kërkuar pezullimin e saj pasi sipas tyre ky është një sistem abuziv. Në deklaratën e saj Albana Vokshi bëri me dije se deputetët e PD-së kanë qenë të pranishëm në disa prej familjeve të përjashtuara që jetojnë në varfëri ekstreme. "Qeveria në mënyrë abuzive ka larguar nga skema e ndihmës rreth 15 mijë familje në Tiranë, 752 familje në Kamzë 682 në Kavajë, 752 familje në Lushnjë, 826 familje në Divjakë e mbi 2000 në Pogradec. Qeveria nuk shpjegon pse ka përjashtuar mijëra nëna kryefamiljare me fëmijë jetimë",-thekson Vokshi. Ndërkaq, edhe kryebashkiakja e Shkodrës Voltana Ademi u shpreh se mijëra persona me aftësi ndryshe janë lënë jashtë skemës, duke mos pasur asnjë të ardhur tjetër financiare, duke e konsideruar tallje nga ana e qeverisë. "Ne si qeverisje vendore, mund të tregojmë mijëra familje që sot nuk kanë as bukën e gojës. Vetëm në bashkitë e djathta janë më se 2000 familje me persona me aftësi ndryshe, të cilave u është mohuar e drejta ligjore për të përfituar nga kjo skemë", - tha Ademi.

NJOFTIM ANKANDI

Përmbarues gjyqësor privat Artan Sima zhvillon ankandet sipas datave të mëposhtme:

1)Datë 16/03/2018, ditën e Premte, ora 16:00, përfundon ankandi i ri (i dytë), për shitjen e pasurive të paluajtshme të llojit:

-"Arë" me sip. 2506 m2, e ndodhur në fshatin Vashtmi Korçë, në vlerën 210,504 lekë.

-"Arë" me sip. 1216 m2, e ndodhur në fshatin Vashtmi Korçë, në vlerën 102,144 lekë.

-"Arë" me sip. 1080 m2, e ndodhur në fshatin Vashtmi Korçë, në vlerën 121,464 lekë.

-"Truall+arë" me sip. 352 m2, nga kjo truall 200 m2, si dhe ndërtesë prej 80 m2, e ndodhur në fshatin Vashtmi Korçë, në vlerën 1,456,504 lekë.

Pasuritë janë lenë garanci bankare nga debitori Trashëgimtarëve të të ndjerit/Debitor z.Algent Minir Panajoti, znj.Manjola Rexhep,Panajoti, znj.Sara Algent Panajoti, z.Glediol Algent Panajoti banues në fshatin Vashtemi, bashkia Maliq, rrethi Korçë, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a, me seli në ish Blloku Tiranë.

2) Datë 16/03/2018, ditën e Premte, ora 16:00, përfundon ankandi i ri (i dytë), për shitjen e pasurive të paluajtshme të llojit:

-"Arë" me sip. 1489 m2, e ndodhur në fshatin Zagfradec Devoll, në vlerën 87,430 lekë.

-"Arë" me sip.1489 m2, e ndodhur në fshatin Zagfradec Devoll, në vlerën 107,520 lekë.

Pasuritë janë lenë garanci bankare nga debitori Trashëgimtarëve të të ndjerit/Debitor z.Xhevair Zama dhe Nexhmije Zama, z.Aurel Zama, z.Sokol Zama, z.Melsi Zama, banues në fshatin Zagradec, bashkia Devoll, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a, me seli në ish Blloku Tiranë.

3)Datë 15/03/2018, ditën e Enjte, ora 16:00, përfundon ankandi i ri (i tretë), për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Arë" me sip. 1.000 m2, truall 190 m2, nga kjo ndërtesë 81 m2 e ndodhur në fshatin Zdojan , Dibër në vlerën 100.800 lekë. Pasuria është lenë garanci bankare nga (debitorët/hipotekues) z. Bedri Allaman Tuka, banues në fshatin Zdojan-Brezhan, bashkia Dibër, rrethi Dibër, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a, me seli në ish Blloku Tiranë.

4)Datë 02/03/2018, ditën e Enjte, ora 16:00, përfundon ankandi i ri (i parë), për shitjen e pasurive të paluajtshme të llojit:

-"Arë" me sip. 7400 m2, e ndodhur në fshatin Bitinçe Devoll, në vlerën 592,000 lekë.

Pasuritë janë lenë garanci bankare nga debitori Trashëgimtarëve të të ndjerit/Debitor znj.Bukurije Sulejman Fezo, znj.Mimoza Fatmir (Foto) Fezo, z.Xhimi Foto Fezo, znj. Arkonnda Foti Fezo, znj. Eliverta Foti Fezo , znj. Luiza Foti (Kasabelli) Fezo banues në fshatin Bitinçe, bashkia Devoll, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a, me seli në ish Blloku Tiranë.

Ankandet zhvillohet pranë zyrës së përmbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga «Avni Rustemi», nr.31 .k,1. Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com

NJOFTIM ANKANDI

Përmbarues gjyqësor privat Artan Sima, në datë 14/03/2018, ditën e Mërkurë, ora 16:00 përfundon ankandi i ri (i dytë), për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Apartament" me sipërfaqe totale 73.40 m2, e ndodhur në Bilisht, lenë garanci nga debitori z. Ramadan Ibrahim Kordalli banues në Bilisht, Bashkia Devoll, për detyrimin ndaj kreditorit znj.Lindita Bere Kordalli, banuese në fshatin Tren, rrethi Devoll, në vlerën 1.080.000 lekë.

Ankandi zhvillohet pranë zyrës së përmbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga «Avni Rustemi», nr.31 .k,1. Korçë.

Kontakt: Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com

SHKURT

Vajza 4-muajshe, viktima e dytë e fruthit në vend

Virusi i fruthit ka shkaktuar viktimën e dytë në vend, duke i marrë jetën një fëmije 4 muajsh që vuante edhe nga bronkopneumonia. Vajza me inicialet R.N nga Peshkopia është sjellë me urgjencë në QSUT, por fruthi ka përkeqësuar gjendjen shëndetësore të saj, duke i shkaktuar vdekjen. Ashtu si në rastin e viktimës së parë të fruthit, vdekja e fëmijës është mbajtur e fshehtë edhe pse vajza kishte humbur jetën në datën 10 shkurt. Deri më tani numri i të prekurve nga virusi i fruthit ka arritur në 87 persona, ndërkohë që fëmijët nën 1 vjeç nuk mund të vaksinohen pasi MMR mund të kryhet vetëm pasi kalohet kjo moshë. Ndërkaq, mjekët u bëjnë thirrje prindërve që të mos paraqiten në QSUT, nëse fëmijët nuk paraqesin një rast urgjence, pasi ekziston rreziku për t'u infektuar nga fruthi.

Rektori Koni mohon akuzat, letër Nikollës

Pas kërkesës së 4 dekanëve të Universitetit të Tiranës, për shkarkimin e rektorit Mynyr Koni, ky i fundit i ka dërguar një letër të hapur ministres së Arsimit, Lindita Nikolla. Rektori i UT-së ka mohuar akuzat kundrejt tij dhe ka theksuar se zgjedhja e tij në krye të universitetit është bërë nga pedagogët dhe studentët. "Rektorin e zgjedhin pedagogët dhe studentët. Flasin dekanët e nderuar "për konstatimin e shkeljeve të rënda dhe të vazhdueshme ligjore në veprimtarinë e Rektorit të UT"....por asgjë nuk është e vërtetë dhe asnjëri prej tyre nuk di të thotë se cilin ligj Rektori ka shkelur dhe cilin nen apo germë të tyre nuk ka zbatuar ashtu siç duhet Rektori.",-citon Koni në letrën e hapur. Gjithashtu, ai thekson se do të dëshironte të ishte njohur nga vetë ministrja Nikolla mbi letrën e dërguar nga 4 dekanët e UT-së në tetor të 2017-ës.

Dosja për marrjen e tapisë dorëzohet nga Agjencia e Legalizimeve në Hipotekë

ALUIZNI, 1900 personat që do të marrin tapitë

Legalizimet, ja kush përfiton në qarkun e Elbasanit

Ornela Manjani

ALUIZNI publikon listën me 1900 personat që kanë ndërtuar pa leje dhe kanë gati lejet e legalizimeve. Përfituesit janë në qarkun e Elbasanit. Drejtoria e ALUIZNI-t bën të ditur se lejet e legalizimeve kanë qenë gati prej kohësh, madje janë dorëzuar edhe në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, por kjo e fundit nuk ka kryer asnjë veprim për pajisjen me certifikatë pronësie të përfituesve. ALUIZNI bën të ditur se brenda pak kohësh të gjithë përfituesit do të pajisen me tapitë për pronën dhe se vonesat në shqyrtimin e dosjeve dhe pajisen me leje kanë marrë fund.

TAPITË

Procedurat për marrjen e tapive do të ndiqen nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në hipotekë. Menjëherë pas regjistrimit të certifikatës së pronësisë, përfituesit do të njoftohen për tërheqjen saj. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesit të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shtojnë poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkese me shkrim. Gjithsej leje legalizimi të dhëna në periudhën 2006-2015 janë 57.000. Sipas ligjit në fuqi, kur ndërtimi pa leje disponohet nga një subjekt, kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore dhe objektit që legalizohet regjistrohen në emër të subjektit që disponon objektin. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve. Në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive, nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

- Dalip Hasani
- Midil Bicaku
- Xhevahir Musai
- Agim Lleshi
- Vasil Prifti Etj,
- Ylli Boshnjaku
- Xhevahir Qosja
- Isuf Dhe Adelina Baça
- Vladimir Sula
- Sherife Tallamishi
- Halit Ibrahimi
- Besnik Bugjëzi
- Përparim Ferhati
- Andri Bicaku
- Aldo Nishku
- Ali Gjata
- Selim Metoshi
- Llazar Sotiri
- Elmas Kalia
- Petrit Lika
- Riza Kamolli
- Avni Çela
- Artur Guxho
- Osman Kaloshi
- Fiqirete Jança
- Urim Bicaku
- Shkelqim Budani
- Zaim Nuhu
- Enver Sula
- Halit Sharra
- Viktor Kavaja
- Alfred Rama
- Besim Balla
- Bashkim Capja
- Jakup Cani
- Qamil Mimini
- Shpetim Bicaku
- Behar Zdrava
- Rust Zena
- Guxim Kullolli
- Ali Nuri
- Skender Kullolli
- Hekuran dhe Eduart Bakiu
- Besim Lluka
- Rben Narta
- Fiknete Bakiu
- Qazim Balla
- Hajdar Mimini
- Arben Hidri
- Tefik Spahiu
- Fiqirete Sallaj
- Asqerije Dedja
- Sali Koleci
- Ramzan Qefa
- Durim Poci
- Lavdim Pepa
- Dervish Hazizolli
- Agron Balla
- Dilaver Dishani
- Asllan Cela
- Bardhul Hasa
- Riza Gorani
- Sherif Tanushi
- Lavdimir Kurani
- Dhimitri Shalcaj
- Hekuran Alla
- Qerim Alla
- Xhevahir Sinani
- Luan Dervishi
- Bashkim Gjokpali
- Tomorr Koleci
- Riza Malja
- Luljeta Prifti
- Besnik Guni
- Alfred Blloshmi
- Ilir Kamolli
- Xhaferr Duraku
- Alfred Haka
- Ferit Koci
- Bajram Bodurri
- Jonus Kalia
- Ylli Luli
- Servet Dauti
- Mirela Zorba
- Suzana Cela
- Arben Drazhi
- Fatmira Mujollari
- Petrit Cekini
- Thanas Nishku
- Novrus Mimini
- Ndricim Blloshmi
- Nazmi Hasani
- Qamil Haka
- Nazmi Hidri
- Neki Jolla
- Gani Blloshmi
- Dilaver Shuli
- Nazmi Koci
- Mersin Dyrma
- Ilmi E Arian Kasa
- Albert Bica
- Agron Shqau
- Zenel Gjata
- Pellumb Salla
- Mehmet Bajramasi
- Shpetim Gjata
- Gani Leka
- Behar Mimini
- Fatos Basha
- Peter Ranxha
- Ilir Basha
- Ardjan Rama
- Vasilika Papa
- Ali Tanushi
- Safet Muzhaqi
- Mark Calladej
- Shkelzen Kaca
- Bardhi Tanushi
- Janq Zguri
- Lulzim Pepa
- Bukuri Shkambi
- Xhevahir Ferra
- Albert Vllahi
- Lulzim Rreshka
- Agim Toma
- Mustafa Methasa
- Petrit Kreca
- Luan Budani
- Bashkim Filja
- Xhevahir Rama
- Roland Stafa
- Sherif Ruci
- Agron Ruci
- Aleksandra Zguri
- Shpetim Cora
- Gezim Drazhi
- Sulejman Kutrolli
- Shkelqim Dini
- Shefqet Rama
- Zeqo Qefa
- Hashim Ademi
- Astrit Filja
- Altevin Budani
- Ramazan Leka
- Enver Budani
- Lutfi Hoxha
- Enkileta Balliu
- Naim Kaculi
- Ardian Leka
- Lutfije Kaculi
- Leonard Xherri
- Hodo Shtylla
- Behar Vllahi
- Ermand Hysa
- Jonuz Budani
- Lutfi Agolli
- Bujar Ruci
- Petrit Pisha
- Mirban Biba
- Qemal Blloshmi
- Skender Deda
- Xhevahir Ruci
- Abaz Pisha
- Mustafa Kaculi
- Sokol Bizhuta
- Sami Xhafa
- Dritan K Aza
- Ardjan Calladej
- Gezim Mustafaj
- Xhevahir Muzhaqi
- Gezim Kotorri
- Agim Kaculi
- Fari Deda
- Fatmir Demiri
- Naze Sharku
- Mustafa Skura
- Halit Cani
- Ramazan Cani
- Xhevahir Roci
- Bajram Muca
- Xhevit Sadiu
- Petrit Allustaj
- Sami Hushi
- Mithat Ruci
- Zeqir Koci
- Shefqet Bicaj
- Ferdinand Pisha
Absolutisht kurrë, fantazira. Diktatori kishte vetëm një preokupim, mbijetesën e Nexhmijes dhe fëmijëve të tij. Për këtë mbijetesë, ai preu kokat e udhëheqjes që buronte e tëra nga zona e parë operative, zgjodhi Alinë, gjë që s’u mor vesh kurrë. E para, Alia ishte komandant divizioni në kohën e masakrave që u kryen nga forcat partizane shqiptare bashkë me ato serbo-malazeze në Kosovë kundër brigadave nacionaliste, kundër njerëzve që shihnin një mundësi shumë të madhe tani të bashkimit të Shqipërisë me Kosovën. Së dyti, e ka thënë një herë Kadare, dhe unë jam i prirur shumë ta besoj, se në një farë mënyrë, Hoxha kishte një kasetë për Alinë. Ishte kjo çështje agjenture apo tjetër, këtë nuk e di, por Kadare e mbante këtë tezë dhe unë kam prirjen ta besoj. Pra, zgjodhi Alinë vetëm për të mbijetuar Nexhmija dhe fëmijët e tij.

Thonë se ai kishte një lloj depozite?

Kishte, pa diskutim. Nuk i takonte atij se ai ishte i fundit në hierarkinë e Hoxhës.

Në ‘92, dy muaj pasi jeni zgjedhur President i Shqipërisë, jeni pritur në Shtëpinë e Bardhë nga Bush i vjetri, dimë që keni diskutuar edhe për Kosovën. Çfarë saktësisht?

Unë nuk mund të them se kishin një plan, një projekt për Kosovën në atë kohë, por ajo çka unë i kam thënë presidentit Bush është kjo: “Situata është dramatike në Kosovë, Millosheviçi ka një projekt dhe ky projekt është ndarja e Kosovës, spastrimi etnik nga pjesa dërrmuese e Kosovës e shqiptarëve dhe nisja e tyre drejt rrafshit të Dukagjinit dhe Shqipërisë”.

Dhe i kam thënë se Shqipëria nuk sulmon Jugosllavinë, por në rast se Milloshevіç ndërmerr hapin më të vogël në këtë drejtim, Shqipëria do të hapë kufijtë dhe shqiptarët do të luftojnë dhe reagojnë si komb i vetëm. I thashë se ne na kanë ndarë e na kanë copëtuar me një padrejtësi historike shumë të madhe, por i drejtova një pyetje: Pse do lëshojnë shtëpitë e tyre ata që kanë mijëra vjet aty? Dhe ai më tha: ‘Right point’, pra pikë e drejtë. I thashë se shqiptarët do rrëmbenin armët për ekzistencën e tyre dhe se do ishte një luftë shumë e egër. Këtë i kam thënë presidentit Bush. Më vonë presidenti Bush ka tërhequr, ka shpallur vijën e kuqe. A u ndikua apo jo nga unë, këtë s’di ta them. Edhe Ibrahimi është pritur më vonë dhe është pritur shumë mirë nga Këshilltari i Sigurimit Kombëtar, ku i ka paraqitur platformën e 13 pikave. A ishin këto shtysa për shpalljen e vijës së kuqe apo jo, këtë s’mund ta them. Por vija e kuqe ishte kjo: nëse ti do të zbresësh me ushtrinë në Kosovë, do të përballesh me të gjithë arsenalin e bombardimeve të SHBA, përveç bombave atomike, të gjitha llojet e raketave. Ky ishte paralajmërimi. Dhe në fakt, ai u përmbajt, kishte korpusin në Nish dhe donte të fuste ushtritë.

Biseda juaj me Bush është thënë se është zhvilluar mbi një hartë për Ballkanin. Është e vërtetë kjo?

Absolutisht po. Ai bisedën me mua e ka filluar me Kosovën, ka marrë një atlas, e hapi atë dhe kemi folur fillimisht për Kosovën. Më pyeti çfarë mendon ti dhe si është gjendja. Dhe unë ia shpjegova të gjitha, i shpjegova planin e Millosheviçit, i shpjegova se është regjim aparteidi dhe segregacioni dhe i shpjegova të gjitha projektet serbe për shfarosjen e shqiptarëve. Kjo ishte pak a shumë ajo bisedë.

Në shtator të vitit ‘95 jeni takuar sërish me presidentin amerikan Klinton në Shtëpinë e Bardhë. A keni biseduar sërish për Kosovën, a kishin ndryshuar qëndrimet e Amerikës ndaj Kosovës apo presidenti Clinton ka vazhduar politikat e presidentit Bush ndaj Kosovës?

Në çdo takim unë e kisha temë kryesore. Në çdo kohë, në mënyrë absolute. Presidenti Klinton natyrisht thoshte mbështesim çdo variant përveç pavarësisë. Sepse të jemi të sinqertë, pavarësinë që mbronte arkitekti i saj Rugova, nuk e mbështeste askush në rrafshin ndërkombëtar, por mbështesnin vendosjen e lirive dhe të drejtave, mbështesnin demokracinë, mbështesnin një hapësirë demokratike, për të cilën nuk e realizuan sepse kishin një njëri që thoshte se ata janë të lirë më shumë se të gjithë europianët dhe ky ishte Millosheviçi.

Po ju vetë, e besonit apo ishit edhe ju skeptik ndaj idesë së Rugovës?

Të shkojmë pak te fillimi bisedës. Midis meje dhe atyre që më dhanë mua leksionet më të mëdha për Kosovën kishte një dallim. Ata nuk besonin kurrë se do ta shihnin më Kosovën, kurse unë nuk besoja se nuk do ta shihja Kosovën të çlirohet. Dhe kjo ide më ka shoqëruar mua gjithë jetën time. Duke ditur të gjithë historinë e Kosovës, kisha një bindje të thellë se nuk do jetë e largët dita kur Serbia s’mund ta mbajë dot dhe kur Kosova të çlirohet prej saj. Unë e kisha këtë bindje, por natyrisht, isha për bashkim kombëtar. Unë u rrita me idealin më të shenjtë, atë të idealit kombëtar. Për mua, Kosova ishte provincë e Shqipërisë dhe nuk mendoja kurrë që duhet të jemi për pavarësi. Kur u angazhova për politikë në vitin ’90, bëra shumë takime me përfaqësues të Kosovës dhe konstatova se ata e kishin serioze idenë e pavarësisë. Në shkurt të ‘91 erdhi Ibrahim Rugova dhe përsëri ai ma shpjegoi dhe theksoi se pavarësia është rruga në të cilën duhet ecur dhe pastaj shihen problemet. Pasi u binda se kjo nuk ishte një tezë fasadë për t’u paraqitur, por ishte një tezë që bazohej në një realitet të cilin unë nuk e njihja, një realitet të krijuar në 50 vite në Prishtinë, atëherë unë e kam mbështetur plotësisht, se përndryshe do dilnim me idera aneksioniste, çka ishte e pamundur për mua që të kisha ato ide. Dhe kam ndryshuar qëndrimin tim, jam pajtuar me idenë e pavarësisë, por isha i bindur në mënyrë absolute se një ditë Kosova do të dalë nga pushtimi serb.

Në kohën kur ju ishit President i Republikës së Shqipërisë, grupe të UÇK-së janë stërvitur brenda territorit të Shqipërisë. Kishte pranuar shteti shqiptar që ato të stërviteshin brenda territorit shqiptar, kishte presion ndërkombëtar që të bëhej kujdes?

Presion ndërkombëtar kishte, këto grupe nuk ishin të mëdha, ishin grupe disa qindra vetash...

Si vendosët t’i përkrahnit?

Që të jemi realistë, që të gjitha këto janë bërë me qeverinë e Kosovës. Qeveria e Kosovës kishte këtu më së shumti dhe kryeministrin, por kishte ministër Mbrojtje, kishte organizimin e vet dhe ishte qeveria e Kosovës, e cila merrej me çdo gjë me ta, kurse ne, si qeveri shqiptare, komunitetit ndërkombëtar i thoshim se ishin refugjatë, u kemi dhënë strehë si refugjatë, por ndodh ndonjëherë që ndonjë prej tyre çojnë foto nëpër ambasada duke u stërvitur. Kjo që u thoshim ne ishte një gjë jo shumë bindëse, por këto nuk ishin të shumtë. Një meritë të jashtëzakonshme kishin ama. Imagjino, një grup i vogël njerëzish, të cilët besojnë se do ta çlirojnë me armë Kosovën është një gjë me të vërtetë e jashtëzakonshme. Dhe në fund të fundit, ai vendim i tyre u tregua përcaktues për çlirimin e Kosovës. Pa diskutim që ëndrrën e pavarësisë e ndërtoi Rugova. Ai ishte një gjeni në politikën shqiptare, sepse arriti të ndërtojë dhe të bëjë një popull të tërë të besojë në projektin e pavarësisë. Por, në një farë mënyre, ndoshta ai e konkretizoi në kushtet e pushtimit, si rrallëkush në historinë e Europës dhe njerëzimit, me pushtetin paralel që krijoi. Pavarësisht se policinë, forcën e kishte Milloshevіçi por popullin dhe shoqërinë e kishte tërësisht Rugova dhe pushteti i tij paralel ishte sfida më e madhe që i bëhej pushtimit serb. Institucionet paralele, parlamenti, shpallja e republikës, shumë njerëzve dhe sot mund t’u duken si akte jo qenësore, por jo, ato ishin akte qenësore, akte thelbësore, sepse mbi to u ndërtua ëndrra e pavarësisë së popullit të Kosovës dhe mbi to kjo ëndërr shkoi në të gjitha kancelaritë e botës, mbi to kjo ëndërr u bë motivi kryesor i luftës dhe sakrificës për liri të mijëra e mijëra vajzave dhe djemve të Kosovës.

Kur ka qenë hera e parë që keni vizituar Kosovën?

Hera e parë që kam vizituar Kosovën për fat të keq e kam vizituar në fatkeqësi. E kam vizituar kur vdiq presidenti Rugova. U nisa një herë tjetër, por UMNIK u tremb, se ata ndiqnin një praktikë idiote që s’duhet t’i lëmë shqiptarët të afrohen se po na bashkohen dhe më njoftuan në Kukës se nuk mund të kaloja kufirin se guvernatori i asaj kohe, Kushner, nuk ka dhënë miratimin. Unë mbajta një konferencë shtypi dhe dënova qëndrimin. Pavarësisht nga kjo, unë kam shumë respekt për punën që Kushner ka bërë për Kosovën, ishte mik, por e bëra një denoncim për qëndrimin e tij në atë rast.

Cila ka qenë biseda juaj me presidentin amerikan Bush, ishit në dijeni që do bënte një deklaratë të tillë?

Ai erdhi me ndjenjat më miqësore për Shqipërinë. Unë edhe me të atin kam pasur shumë miqësi. Në zyrë më pyet dhe më kërkon t’i flisja për Kosovën dhe situatën në rajon. “Cila është zgjidhja që mendon ti”, - më pyet. Dhe unë i them se pavarësia është e vetmja zgjidhje dhe i bëj argumentimin. Më pyeti “kur mendon ti?”. Anëtarët e delegacionit shtangën. E kuptova që shtangën sepse mendonin se unë do t’u thosha pas dy javësh. Natyrisht, unë i thashë se meqë ju e keni ndarë mendjen për këtë punë, merrni kohën që ju duhet, ne u jemi mirënjohës sepse kjo është një gjë e jashtëzakonshme, por përsëri merrni kohën që ju duhet për të diskutuar me partnerët këtë çështje. Ai vinte nga takimi i Grupit të 8 në Gjermani, ku për hir të së vërtetës nuk e kishin mbështetur idenë e pavarësisë. Fillimi i vitit 2005 pati një lloj ujdie që s’kemi zgjidhje tjetër përveç pavarësisë, pastaj se çfarë ndodhi në gjysmën e dytë të 2005 dhe fillim 2006, por në Europë përveç britanikëve, e vërteta është që nuk e mbështeste më njëri.

E kujtoni si u ndjetë kur deputetët nga Kuvendi i Kosovës shpallnin pavarësinë?

Pas pavarësisë së Shqipërisë, ajo ishte dita e dytë më e rëndësishme e shqiptarëve. Natyrisht, pavarësia e Shqipërisë qe një gjë e madhe se u arrit që të ketë një shtet që të shërbejë si pikënisje për projekte të tjera. Për mua ajo ka qenë dita më e gëzueshme e jetës sime.

SIGURIMI I SHTETIT
DOKUMENTET

EKSKLUZIVE/ Zbulohet dokumenti sekret i Sigurimit të Shtetit, ku bëhet fjalë për manovrat që u përdorën për arrestimin e Prek Calit më 14 shkurt të 1945-ës

"Si e kapëm Prek Calin me 12 krerë të reaksionit në Kelmend"

Dashnor Kaloçi

Plot 73 vjet më parë, pas një rrethimi afro dymujor që iu bë krahinës së Kelmendit në malësinë e Mbishkodrës, forca të shumta partizane të Brigadës së Parë Sulmuese, që asokohe ishte nën komandën e Korpusit të III dhe kryesonin atë operacion, arrestuan Prek Calin dhe 12 burra të tjerë që e shoqëronin atë. Kjo ngjarje bëri bujë të madhe në atë kohë jo vetëm prej emrit dhe autoritetit të jashtëzakonshëm që kishte Prek Cali, por edhe për shkak të humbjeve të mëdha që pësuan si forcat partizane të Brigadës së Parë Sulmuese, që u detyruan të marshonin edhe në viset shqiptare nën Malin e Zi për rrethimin e tij, ashtu edhe të njerëzve që e shoqëronin Prek Calin, gjatë asaj kohe afro tremujore që ai u detyrua të qëndronte maleve në arrati. Lidhur me Prek Calin apo dhe posaçërisht për këtë ngjarje, është folur dhe shkruar shumë pas viteve '90-të, por vitin e kaluar figura e Prek Calit u bë "mollë sherri" edhe në mes të dy forcave politike në vend, pas asaj që ndodhi me kullën e tij në Vermosh. Por ndryshe nga sa më sipër cituam, në këtë shkrim po publikojmë një dokument sekret të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili tregon se si është arrestuar Prek Cali dhe njerëzit që e shoqëronin atë më 14 shkurt të vitit 1945. Këtë dokument e kemi shkëputur nga një studim i gjatë (mbi 1200 faqe), që ka qenë përgatitur nga një grup pune i Ministrisë së Punëve të Brendshme para viteve '90-të, (i kryesuar nga Th.B.), ku pasqyroheshin të gjitha "sukseset" e Sigurimit të Shtetit nga viti 1943, që u krijua bërthama e parë e Sigurimit të Shtetit e deri në mesin e viteve '80-të. I gjithë fashikulli ka qenë "Tepër Sekret" dhe ai përdorej si leksion për studentët e Shkollës së Ministrisë së Punëve të Brendshme ndër vite. Edhe pse i gjithë fashikulli është i mbushur edhe me shumë propagandë, aty ka një material të bollshëm dhe tepër të detajuar për mënyrën se si ka funksionuar "arma e Sigurimit të Shtetit" që nga krijimi i saj e deri në mesin e viteve '80-të. Dokumenti publikohet për herë të parë ekskluzivisht për "Gazeta Shqiptare".

Prek Cali

DOKUMENTI I SIGURIMIT: Gjatë kësaj faze Shërbimi Informativ theksoi se kushtrimin e luftës kundër forcave partizane e kishin dhënë Zef Nika, Ujk Lula dhe Preng Doda nga Vukli, të cilët u kapën. Gjithashtu, u kapën dhe u ekzekutuan Nikoll Tona dhe Nik Marashi, që kishin vrarë korrierët e Brigadës së Parë, që u dërguan me shërbim në Vukël".

DOKUMENTI SEKRET MBI OPERACIONIN PER KAPJEN E PREK CALIT

Ndërkohë, komandant e vendit informonin se reaksionarët kishin tërhequr shumë veta nga populli, duke i frikësuar se do t'u digjnin shtëpitë dhe fëmijët po të ndihmonin Mbrojtjen. Të dhënat tregonin përgatitjen që po bënte reaksioni.

"Në rajonin tonë - shkruante komanda e vendit e Dukagjinit më 3 janar 1945 - gjendja është kritike. Elementë të ndryshëm gjakësorë sillen nëpër katunde! Situata po zhvillohet në mënyrë të tillë që mund të fillojë lufta. Dërgoni forca ushtarake". Në të dhënat thuhej se krahas klerikëve reaksionarë, bajraktarët e parisë me influencë, kriminelët e luftës dhe agjenturat e huaja që ishin hedhur në luftë të armatosur kundër pushtetit popullor, reaksioni tërhiqte në këtë luftë edhe njerëz të tjerë, duke shfrytëzuar jo vetëm ata që ishin kompromentuar me reaksionin, por edhe lidhjet e tyre miqësore, tarafet dhe fiset. Shfrytëzonin zakonet dhe traditat e vjetra. Armiqtë kishin shtënë në dorë edhe mjaft persona të kështillave të vendit dhe të këshillave të fshatrave në mjaft zonave të Veriut, duke përdorur kërcënimet e njerëzve të besuar dhe duke i zëvendësuar ata me elementët e vet.

Më 6 janar 1945, komanda e vendit të Vermoshit dhe Kelmendit informonte komandën e qarkut të Shkodrës, se: "Në fshatrat Nikç e Ranca e Shnikut po strehoheshin reaksionarë shqiptarë dhe jugosllavë si Preng Cali, Sali Nikçaj etj. (Arkivi i M.M.P., Fondi i Korpusit të III, dosja 3, shkresa nr.70, dt.3.1.1945, i Komandës së Vendit Dukagjin dhe i Komandës së Qarkut të Shkodrës, dërguar Korparmatës së III).

Megjithëse e shihte se forcat reaksionare ishin të shumta, ajo theksonte se kishte marrë masa duke organizuar roje partizane me fshatarë. Ajo kërkonte forca ushtarake për asgjësimin e reaksionarëve, pasi ata ishin të shumtë.

Në këtë mënyrë, komandat e vendit krahas organeve të tjera të mbrojtjes së popullit, nuk kryenin vetëm detyrën e informimit dhe ruajtjen e rendit dhe të qetësisë, por merrnin edhe masa për kërkimin, ndjekjen dhe asgjësimin e kriminelëve.

Në të njëjtën kohë, duke parë se kriminelët kishin mashtruar shumë njerëz të pafajshëm, të cilët si rezultat i punës së reaksionit kishin dalë në arrati, komandat e vendit krahas asgjësimit me forca të armatosura, përdornin edhe forma pune bindëse, duke u bërë thirrje për dorëzimin e të arratisurve, nëpërmjet takimeve me të arratisurit që kishin influencë, ku bëhej "marrëveshja" për dorëzim. Gjithashtu, komandat e vendit bënin edhe listat e të arratisurve. Këto lista ua dërgonin komandave të qarqeve - oficerit të mbrojtjes së popullit, i cili ia përcillte seksionit të mbrojtjes së popullit të krahinës. Kjo ndikonte që operacioni i spastrimit të kryhej me sukses.

Në përshtatje me veçoritë që paraqiste lufta kundër reaksionit të brendshëm, operacioni në këto krahina nuk u bë njëlloj. Në Veri reaksioni vepronte me grupe të mëdha kriminelësh nga 50 deri në 400 veta të armatosur dhe të organizuar mirë, ndërsa në jug dhe në Shqipërinë e Mesme, në grupe të vogla, të shkëputura. Në Veri, reaksioni përgatitej të rezistonte duke luftuar me armë, kurse në Jug, organizonte akte terrori, diversioni e sabotazhi. Kjo bënte të domosdoshme që edhe taktika e veprimeve të forcave tona, t'i përshtatej asaj të armikut - veprimit me grupe të vogla, duhej përgjigjur po kështu. Nuk kishte kuptim që për organizimin, rrethimin e asgjësimin e një grupi të vogël, të angazhohej divizion ose brigadë e tërë.

Për këtë arsye, ndërsa në Veri vepronin formacione të mëdha të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, në zonat e Jugut dhe të Shqipërisë së Mesme u organizuan grupe të vogla me partizanë trima, të shkathët dhe besnikë, të cilët së bashku me popullin, komandat e vendit, kështillat nacional-çlirimtare, komandat e vendit, repartet e ndjekjes dhe mbrojtjes së popullit, organizonin prita, kapnin ose asgjësonin grupet e kriminelëve të arratisur. "Këtu të përdoren dhe ata që kanë armiqësi të vjetra personale, për informata", - theksonte shoku Hysni Kapo, komisar i Korpusit të Parë, në udhëzimet që u dërgonte organeve dhe reparteve më 24.1.1945.

Në disa krahina të Veriut, si Hoti Kelmendi, Gruda, si rezultat i mashtrimit që kishte bërë armiku, shumë persona ishin ngritur në rezistencë të hapur dhe refuzonin të merrnin pjesë në radhët e U.N.Ç.SH. Ndër ta si në Malësinë e Shkodrës, Gjakovës etj., mbanin qëndrim indiferent ndaj pushtetit popullor. Mbeturinat e reaksionit në këto zona ishin të armatosura me pushkë e mitraloza dhe prisnin rastin për t'u hedhur në aktivitet kundër-

➔

Ushtarë të Divizionit të Mbrojtjes së Popullit të MPB 1945

Sipas kujtimeve të At Zef PIlumit



Peshkopise, te zhduknin e asgjesonin çde force reaksionare, te organizuara ose jo.

Zhvillimi i operacionit te spastrimit.

Operacioni i spastrimit filloi ne te gjitha krahinat. Ai u zhvillua ne dy faza:

Faza e pare filloi ne, 14 janar 1945 deri ne 31 janar 1945. Ne keto faze u pershkuan gjithe fshatrat e zones se Veriut duke asgjesuar çdo rezistence, u kapen pikat strategjike qe dominonin ne krahine dhe u be mobilizimi. Kudo qe shkonin forcat partizane riorganizonin dhe rrjeten informative, duke u bazuar edhe ne fshataret qe nuk implikoheshin rende ne reaksionin, qoftë kjo edhe me anë

zbuluara me bore, ne mbeshtetje te te dhenave te sigurta qe kishin mbledhur nga sherbimi informativ i terrenit, nga fshataret dhe nga zbuluesit qe u derguan ne zonat e thella, bene goditjen e armikut, qe gjendej ne zonen e Kelmendit, nga pese drejtime.

Veprimet ne kete faze u kombinuan mire dhe u arrit qe brenda pesembedhjete diteshit te pare te shkurtit 1945, te sigurohej çdo e papritur, goditje te befasishme ne prita dhe te asgjesoheshin forcat e reaksionit, te spastrohej Kelmendi krejt, duke kapur gjallë kriminalin Preng Cali me 12 krere te reaksionit që kryesonin forcat reaksionare. Krahas kësaj u be çarmatimi i gjithe atyre qe implikoheshin me reaksionin, u organizua pushteti dhe u be mobilizimi i detyrueshem ushtarak.

Gjate operacionit ne Kelmend forcat tona paten 39 te

zbuluara me bore, ne mbeshtetje te te dhenave te sigurta qe kishin mbledhur nga sherbimi informativ i terrenit, nga fshataret dhe nga zbuluesit qe u derguan ne zonat e thella, bene goditjen e armikut, qe gjendej ne zonen e Kelmendit, nga pese drejtime.

Veprimet ne kete faze u kombinuan mire dhe u arrit qe brenda pesembedhjete diteshit te pare te shkurtit 1945, te sigurohej çdo e papritur, goditje te befasishme ne prita dhe te asgjesoheshin forcat e reaksionit, te spastrohej Kelmendi krejt, duke kapur gjallë kriminalin Preng Cali me 12 krere te reaksionit që kryesonin forcat reaksionare. Krahas kësaj u be çarmatimi i gjithe atyre qe implikoheshin me reaksionin, u organizua pushteti dhe u be mobilizimi i detyrueshem ushtarak.

Gjate operacionit ne Kelmend forcat tona paten 39 te

revolucionar. Në këto zona si dhe në të tjera ku reaksioni kishte baza, armiku lëshonte parulla për të krijuar mosbesim ndaj qeverisë demokratike, pakënaqësi dhe përçarje në popull. "Mbeturinat e reaksionit në Shqipëri kanë mbledhur veten dhe zhvillojnë aktivitet të shumanshëm", theksonte shoku Enver Hoxha në urdhrin e operacionit të 19 janarit 1945 dërguar Shtabit të Korparmatës së III.

Pushteti popullor në zonën e Shkodrës dhe Kukësit nuk i kishte forcuar ende bazat e tij, ai kërcënohej përherë nga reaksioni. Kjo rridhte pasi forcat partizane të Korparmatës së III ende nuk kishin kaluar në të gjitha fshatrat. "Nëse nuk do të merren masat - udhëzonte shoku Enver Hoxha - këto forca reaksionare dhe çerdhe të reaksionit mund të bëhen vatër e lëvizjes reaksionare dhe të kërcënohet pushteti". Duke studiuar këtë gjendje, shoku Enver Hoxha urdhëroi që forcat e Korparmatës së III të kalonin në të gjitha nënprefekturat e Qarkut të Shkodrës dhe të Kukësit, nënprefekturës së Peshkopisë, të zhduknin dhe asgjësonin çdo forcë reaksionare të organizuar apo jo.

ZHVILLIMI I OPERACIONIT TË SPASTRIMIT

Operacioni i spastrimit filloi në të gjitha krahinat. Ai u zhvillua në dy faza: Faza e parë filloi më 14 janar 1945 deri më 31 janar 1945. Në këtë fazë u përshkuan të gjitha fshatrat e zonës së Veriut, duke asgjësuar çdo rezistencë. U kapën pikat strategjike, që dominonin në krahinë dhe u bë mobilizimi. Kudo që shkonin forcat partizane, riorganizonin dhe rrjetën informative, duke u bazuar edhe në fshatarët që nuk implikoheshin rëndë me reaksionin, qoftë kjo edhe me anë premtimesh, me qëllim që të mblidhnin të dhëna të sakta mbi qëllimet dhe lëvizjet e armikut.

Taktika e luftë kundër reaksionit duhet të çonte në realizimin e qëllimit strategjik: asgjësimin e plotë të reaksionit. Për këtë arsye, gjatë operacionit u përdor taktika e luftës-manovër rrethonjëse.

Gjatë fazës së parë, si rezultat i mospasjes së një organizimi të mirë të shërbimit të kundërzbulimit dhe i mungesës së të dhënave mbi gjendjen, qëllimin dhe lëvizjen e reaksionit, forcat tona ushtarake patën humbje të mëdha! Nga mosmarrja e masave zbuluese, ranë shpeshherë në prita të befasishme.

1.(Urdhrin që shoku Enver dërgoi më 19 janar 1945 për të shkelur e spastruar të gjitha fshatrat e Veriut, Shtabi i Korparmatës së III nuk e kishte zbatuar). Kjo vinte për faktin se reaksioni u nënvlerësua dhe se numri i forcave tona që u dërguan për ndjekjen dhe asgjësimin e tij në këto zona që më i pakët se numri i kriminelëve të arratisur: terreni strategjik i panjohur nga forcat tona nuk evidentonte dot pritat dhe befasitë që banditët e armatosur u bënin forcave tona. Armiku, duke e njohur mirë terrenin, kishte mundur të zinte të gjitha pikat dominuese e rrugët. Gjithashtu, mungesa e njohurive taktike të përgjegjësve që drejtonin operacionin në këto zona shpinte në moskombinimin e veprimtarisë së forcave të tyre me forcat e tjera, që këto të shkonin paralel. Të gjitha këto vinin edhe nga mungesa dhe mosvlerësimi i rrjetës informative.

Kjo dobësi si dhe humbjet që pësuan forcat tona në fazën e parë, u korrigjuan në fazën e dytë, që filloi prej 1 deri më 14 shkurt 1945. Gjatë kësaj faze, forcat e U.N.Ç.SH. (Ushtria Nacional-Çlirimtare Shqiptare), duke kaluar pengesat e mëdha natyrore, duke përshkuar majat, qafat e grykat e mbuluara me borë, në mbështetje të të dhënave të sigurta që kishin mbledhur nga shërbimi informativ i terrenit, nga fshatarët dhe zbuluesit që u dërguan në zonat e thella, bënë goditjet e armikut që gjendej në zonën e Kelmendit, nga pesë drejtime.

Veprimet në këtë fazë u kombinuan mirë dhe bënë që brenda pesëmbëdhjetëditëshit të parë të muajit shkurt 1945, të sigurohej çdo e papritur, goditje të befasishme në prita dhe të asgjësoheshin forcat e reaksionit, të spastrohej Kelmendi krejt dhe të kapej i gjallë Preng Cali me 12 krerë të reaksionit që kryesonin forcat reaksionare. Krahas kësaj, u bë çarmatimi i të gjithë atyre që implikoheshin me reaksionin, u organizua pushteti dhe bë mobilizimi i detyrueshëm ushtarak.

Gjatë operacionit në Kelmend, forcat tona patën 39 të vrarë e 48 të plagosur. Nga këta, 30 të vrarë dhe 34 të plagosur ishin partizanë të Brigadës së Parë, kurse nga ana e armikut, pati 44 të vrarë dhe 21 të plagosur. (1. Arkivi i M.M.P. dhe Fondi i Qarkorit të Shkodrës dhe i Brigadës së Parë 1944-1946).

Gjatë kësaj faze Shërbimi Informativ theksoi se kushtrimin e luftës kundër forcave partizane e kishin dhënë Zef Nika, Ujk Lula dhe Preng Doda nga Vukli, të cilët u kapën. Gjithashtu u kapën dhe u ekzekutuan Nikoll Tona dhe Nik Marashi, që kishin vrarë korrierët e Brigadës së Parë, të cilët u dërguan me shërbim në Vukël.

Veç këtyre, u internuan familjet e reaksionarëve, u arrestuan 12 nxitësit dhe shkaktarët kryesorë të reaksionit në Kelmend.

Si gjithmonë, edhe gjatë operacionit në Kelmend, Partia i kushtoi kujdes të madh punës politike bindëse, edukative në masat e popullit për t'i sqaruar ato rreth veprimeve të forcave ushtarake dhe veprimeve të kriminelit Preng Cali.

Kështu, Kelmendi në këtë operacion njohu mirë drejtësinë e vijës së Partisë Komuniste Shqiptare. Kelmendi, që kishte qenë vazhdimisht nën influencën e reaksionit, që ishte i vetmi vend pa u shkelur nga forcat e U.N.Ç.SH. deri në fillimin e operacionit, u bë një vatër e rëndësishme për asgjësimin e kriminelëve.

Reaksioni dhe rezistenca më e ashpër që në dy bajraqet e Kelmendit, Nikç dhe Vukël.

Në luftën për asgjësimin e forcave të armatosura të reaksionit, forcat e repartet e U.N.Ç.SH. përdorën taktikën - manovrën rrethonjëse e goditjen e rrufeshme. Për këtë, më parë grumbullohesin të dhëna, shoshiteshin ato, bëhej rrethimi, dërgoheshin grupe sulmuesish dhe bëhej goditja në të njëjtën kohë nga të gjitha drejtimet. Këtu filluan të grumbullohen dhe të organizohen të gjitha mbeturinat e reaksionit. I ashpër qe reaksioni sidomos në Brojë, Ura e Tamarës etj. Por këtu edhe ata u asgjësuan plotësisht.

Hyrja e forcave të U.N.Ç.SH. në mënyrë të papritur nga drejtime të ndryshme ngjalli panik në të gjithë reaksionin. Kjo bëri që çdo rezistencë të shuhet me të parë forcat e U.N.Ç.SH. Të gjithë burrat e fshatrave të Kelmendit, sidomos Brojës dhe Rahovicës, që ishin larguar nga familjet si rezultat i punës së reaksionit, u kthyen.

Veprimet e drejta, të matura dhe korrektësia me popullin si dhe kapja gjallë e krerëve të reaksionit, bëri që populli të afrohet më shumë me SEMP-ve (Seksionet e Mbrojtjes së Popullit) dhe u bë baza e mbështetja kryesore për zbulimin e të gjithë kriminelëve e tradhtarëve të tjerë të fshehur.

Divizioni i Mbrojtjes së Popullit, 1945

Dje në 'Deutsche Welle'

BE qorton 'Facebook' dhe 'Twitter'

(Vijon nga faqja e parë)

... veçanërisht 'Twitter' nuk kanë vepruar kështu. Pika shumë të rëndësishme ata i kanë marrë parasysh vetëm pjesërisht, bëri të ditur Komisioni Evropian. Veçanërisht janë procedurat për bllokimin e përmbajtjeve dhe të llogarive të përdoruesve' ku ndeshen problemet më të mëdha.

Komisarja për Drejtësinë e BE, Vera Jourova deklaroi se propozimet e paraqitura deri tani nga këto sipërmarrje janë të pamjaftueshme. "Mbrojtja e konsumatorëve në BE duhet respektuar", tha Jourova. "Nëse sipërmarrjet nuk i përmbahen kësaj, ato duhet të mbulohen me gjoba".

Këtyre sipërmarrjeve u qe kërkuar që në nëntor të 2016-ës që ta përshtatin mbrojtjen e tyre për konsumatorët me rregullat e BE. Sipas vlerësimit të komisionit, 'Twitter'i vazhdon t'i ndryshojë kushtet e përgjithshme tregtare pa i informuar për to përdoruesit.

Përdoruesit e 'Twitter'-it dhe të 'Facebook'-ut veç kësaj nuk informohen në kohën e duhur dhe jo mjaftueshëm për fshirjet që i kërcënojnë të përmbajtjeve të dyshuara si ilegale, kritikoi komisioni.

Edhe për mundësinë që të paraqitet ankesë kundër fshirjeve që priten ose që kanë ndodhur nuk jepet informacion i mjaftueshëm. Një zëdhënëse e 'Facebook'-ut deklaroi në lidhje me kritikat se këtë vit janë parashikuar ndryshime. Këtu bën pjesë psh., mundësia për t'i informuar përdoruesit më mirë për fshirjen e përmbajtjeve.

Jourova tha më tej se rrjetet sociale i përdorin si platforma publicitare dhe tregtare dhe ato duhet t'u përmbahen nga ky shkak rregullave të mbrojtjes së konsumatorëve. Kërkesa qendrore të Komisionit të BE ishin psh., një e drejtë tërheqjeje në blerjet në internet dhe kompetenca e gjykatave evropiane, që të ngrenë padi mbi bazën e së drejtës nacionale. Më parë 'Google', 'Facebook' dhe 'Twitter' parashikonin që në rast konflikti, ai të zgjidhej mbi bazën e ligjeve të Kalifornisë, sepse atje e kanë qendrën këto firma.

HOROSKOPI

DASHI

Nganjëherë jeni shumë të shpejtuar dhe drastikë. Bën mirë ta merrni parasysh këtë gjë, sepse ndodh që persona rreth jush të shqetësohen. Vazhdoni të angazhoheni për punët profesionale, por lejojini vetes edhe pak kohë të lirë dhe shijoni emocione të ndryshme nga e zakonshmja.

DEMI

I keni idetë e qarta. Doni një raport sentimental të qëndrueshëm dhe do të angazhoheni për ta realizuar. Do të arrini rezultatin e dëshiruar. Do t'ia dilni më në fund të bëni gjënë e duhur dhe në drejtimin e duhur. Suksesi është i garantuar.

BINJAKET

Për shkak të Uranit kundra, bëni kujdes nga marrëveshjet e bëra dhe padituria juaj në situata pak të qarta. Por mos reagoni në mënyrë të tepruar. Me Hënën jo shumë të favorshme, sot do të ndiheni të pushtuar nga mëdyshje që do të bëjnë të jini të paqartë.

GAFORJA

Me mbështetjen e Hënës mike përfitoni për të pasur qetësi në çift, pas një periudhë kontradiktash. Mos shkaktoni zënka të kota me partnerin, mos e tejkaloni cakun me kërkesa tekanjoze!

LUANI

Sot me ogurin e mirë nga qielli të Venusit, Marsit, Jupiterit dhe Uranit, do të përjetoni gjëra të reja pozitive në fushën e dashurisë. Keni nevojë të ndryshoni, të bëni gjëra të reja, të sillni ndryshime në ekzistencën e juaj.

VIRGJERESHA

Mjafton të mësoni të vëzhgoni, do të zbuloni se jeta çdo ditë mund t'ju dhurojë ato gjërat e vogla të bukura, që mund të bëjnë të lumtur cilindo prej nesh. Bëni kujdes nga lodhja nervore, jeni shumë të ndjeshëm dhe përfshiheni shpejt në gjendjen emocionale të të tjerëve.

PESHORJA

Nuk do të mungojnë diskutimet me të afërmit dhe për rrjedhojë, sqarimet. Duhet të tejkaloni një këndvështrim shumë personal të çështjeve familjare. E mira është të marrësh në konsideratë të mirat e të këqijat e veprimeve tuaja, por kjo nuk duhet të kthehet në një pengesë.

AKREPI

Në qiellin tuaj Hëna do t'ju bëjë të kuptoni se nga kanë ardhur disa tensione ekzistuese në shtëpi si edhe do t'ju mundësojë t'i zgjidhni. Do të gjeni zgjidhje të papritura për probleme që ju kanë bërë të ndiheni të bllokuar, duke bërë të merrni frymë lirisht.

SHIGJETARI

Për sa u përket ndjenjave, duhet të zgjidhni me zgjuarsi personat që frekuentoni, nëse nuk doni të humbni kohë me lidhje që nuk ju përmbushin. Do të kuptoni se realiteti, të cilit me raste prireni t'i shmangeni, është më i mirë sesa ëndërrimi.

BRICJAPI

Në çështje familjare duhet të punoni për të harmonizuar kërkesat e ndryshme, që rrezikojnë të bien ndesh me njëra-tjetrën. Mësoni të dëgjoni më shumë të tjerët. Nëse nuk arrini të gjeni një marrëveshje të kënaqshme, mos u nxitoni, më mirë të ndryshoni vendimin.

UJORI

Nëse jeni duke jetuar një histori të bukur dashurie, bëni kujdes për të mos komplikuar atë që është e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë. Kush është beqar ka mundësi të shkëlqyera për një takim të këndshëm. Organizoni një shëtitje në natyrë për të meditуar mbi zgjedhjet tuaja më të fundme.

PESHQIT

Favorizimi nga Jupiteri do t'ju sigurojë mbështetjen e miqve tuaj të besuar, me të cilët mund të ndani përvoja të bukura dhe idetë më frymëzuese. Miqtë do t'ju ndihmojnë edhe për zgjidhur çështje të mërzitshme praktike. U jini mirënjohës.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. U shkrua nga Zweig.
5. Fillojnë aksionin.
7. Janë për t'u kremtuar.
13. Sejdini i tarinerëve.
15. Ai i i Don Kishotit ishte Sanço Pança.
17. Ekstreme në tunel.
18. I ka tek vrapi.
20. Fillojnë andej.
21. Nuk tregohet nga i pasigurti.
26. Luftojnë me pagesë.
27. Inicialet e Gere aktor.
29. Sirena që i dha emrin Napolit.
30. Gjysmë fejese.
31. E ka simbolin Co një i tillë.
32. Inicialet e Kazan, regjisor.
33. Turner aktore.
34. Në radhë të parë.
35. As unë as ti.
36. Janë galeri në rrugë.
38. Gibson aktor.
39. Ritet pa zë.
41. Eshtë edhe ajo e futbollit.
42. Një studio... skulptori.
44. Janë fushat pa fund në veri të Orinokos.
46. Fund shkurti.
47. Fillojnë ideologjinë.
48. Eshtë materia e trurit.
49. Një është atleti
50. Eshtë ajo që i ka lënë pas të gjithë.

VERTIKAL
1. Eshtë edhe ajo epizootike.
2. Një është edhe Korabi.
3. I këni në dorë.
4. Eshtë mbulesë mbi... hambar.
6. Kufijtë e kujtesës.
7. Janë tek në faqe.
8. Kështu përfundon Loreley.
9. Një vend nisjeje.
10. Në këtë moment.
11. Në krye të artistëve.
12. Robbins aktor.
14. Ai i Hekurt ishte Bismarck.
16. Qërohen me... llogari.
19. U shkrua nga Kundera.
21. Eshtë dhuna me fjalë.
22. Yoko e John Lennon.
23. Një vepër... taumaturgu.
24. Ente Ekonomike Autonome.
25. Një mund të jetë cirku.
26. Janë indigjenë neozelandezë.
28. Eshtë edhe ajo gjeografike.
29. Inicialet e Klee piktor.
30. Ishin formacionet e famshme maqedonase.
33. Eshtë e zakonshme për pushime
37. Emil piktor.
38. Një planet i Kuq.
40. Një garë në hipodrom.
43. Me të nxjerrin një litër.
45. Qorre pa qe.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Eshtë trofe sportiv.
3. U hahen... të martuarve.
9. Kufizojnë një truk.
11. Kërcimi i Zorba Grekut.
12. Mund të jenë kohore.
15. Kardashian, aktore dhe modele.
16. Janë përmasa.
17. Eshtë pjesë e gjuhës.
18. Nafta e Shell.
20. Një i dhjetë në vit.
21. Letra pa zë.
23. Janë qederet, dëmet.
24. Ishin kundërshtarë të babilonasve.
26. Eshtë llon papagalli.
27. Tregon çmimin me... mirësjellje.
30. Fillojnë ndeshjet.
31. Të parat në stadium.
32. Eshtë vjelje me... drapër.
34. Opera e Verdi-t.
36. Qe një markë makine.
38. Inicialet e Asimov.
39. Ta... ktheni së prapthi.
40. Një version i FIAT.
41. Eshtë çelësi.
42. Eshtë si sobë.

VERTIKAL
1. Në krye të kryesisë.
2. Eshtë shfaqje e parë.
3. Ross këngëtare.
4. Kërkojnë talent të tilla.
5. Të parat në stadium.
6. Një pjesë e makinacioneve.
7. Vrau Hektorin.
8. Roth aktor
9. Që piktor i famshëm italian.
10. Janë vjedhës.
11. Kompozitori i Sinfonia e dymbëdhjetë
12. Një çiklist në velodrom.
13. Eshtë e ardhur nga firmat piramidale.
14. Pak diktaturë.
18. Një mund të jetë me... ku-ku.
19. Nota e diapazonit.
21. Masin lëngje të tilla.
22. Janë forma.
23. I vidhet ustait.
25. Eshtë pjesë telefilmi.
28. Pikas pa ekstreme.
29. Eshtë ëmbëlsirë me qiri.
31. Umberto poet italian.
33. Dy asa.
34. Kollet por jo kot.
35. Radioteleviziont i Kosovës.
37. Inicialet e Delon.
39. Fillojnë afërsisht.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

		7	3				1	8
	6		2					5
		3		5	8	9		6
7				9		8	6	
	9		8		3		2	
	5	4		2				3
4		6	5	1		7		
1					4		8	
3	2				6	4		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	6	2	9	7	4	5	8	1
5	7	8	3	2	1	4	6	9
1	9	4	6	8	5	2	7	3
6	8	1	7	5	2	3	9	4
7	4	3	8	1	9	6	2	5
9	2	5	4	6	3	8	1	7
8	3	6	5	9	7	1	4	2
2	5	9	1	4	8	7	3	6
4	1	7	2	3	6	9	5	8

Argëtim filozofik

- Njeriu që vepron qëndron më pranë njerëzve se sa njeriu që shkruan dhe është në dorën e njerëzve që idetë e reja, të përkthehen në gjuhën e ashpër të veprave.
(Rudru Uillson)
- Njeriu i zgjuar sheh aq sa duhet, jo aq sa mundet.
(Montanj)
- Kur i drejtoheni forcës, një nuk duhet të bëni kurrë: të humbisni.
(Duajt Ajzenhauer)

KRIPTOSKEME



KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

K	A	■	D	A	G	■	■	■	G	U	R	I
D	E	L	I	K	A	T	■	D	E	T	A	R
■	K	■	H	E	R	E	M	I	T	I	■	O
H	■	B	A	J	A	D	E	R	A	■	E	N
A	P	■	T	T	T	■	T	E	■	U	M	I
P	A	M	J	E	■	T	A	K	A	T	I	■
E	L	■	E	■	R	■	L	E	K	U	R	A
S	A	S	T	R	E	■	E	T	I	■	A	D
I	D	E	■	I	N	A	T	■	R	E	T	E
R	I	K	■	L	E	K	■	K	A	U	■	T
A	N	T	I	K	■	T	E	J	■	R	R	E
T	E	I	■	E	T	I	M	O	L	O	G	■

PËRGJIGJIET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALEKRYQI (1)

S	■	A	U	T	O	K	R	I	T	I	K	A	T
A	K	S	I	O	N	■	E	T	E	■	A	T	R
R	U	E	■	P	■	K	A	■	R	K	■	O	A
A	L	■	P	■	M	A	L	O	R	E	■	M	K
H	E	R	E	M	I	T	I	■	E	N	T	E	T
■	T	I	R	A	N	E	T	■	N	D	E	■	A
T	A	R	I	K	A	T	E	T	■	E	T	A	T
U	■	■	M	I	T	E	T	■	S	T	A	N	I
R	■	R	E	N	O	■	■	L	H	■	R	D	■
K	R	A	T	E	R	■	F	A	T	A	■	R	E
E	S	M	E	R	■	T	A	L	E	N	T	E	T
T	■	A	R	I	■	A	N	A	T	E	M	A	T

FJALEKRYQI (2)

M	A	R	S	H	I	■	S	A	S	■	S	P	A
A	M	I	T	A	■	K	E	M	I	S	H	A	T
R	A	S	A	■	K	A	R	A	N	T	I	N	A
I	D	I	■	K	A	P	I	T	A	L	■	D	■
N	O	■	M	O	N	O	T	O	N	■	K	I	T
E	■	P	I	R	A	T	E	R	I	A	■	T	O
S	P	I	T	A	L	E	■	I	■	R	R	■	N
■	E	M	I	L	E	■	I	■	E	M	I	L	Y
V	D	■	K	E	T	■	K	A	M	A	T	E	■
A	R	T	E	■	■	F	O	N	E	T	I	K	A
J	O	E	■	M	I	S	T	E	R	I	■	E	R
I	■	R	O	M	A	K	E	T	■	M	A	T	A

Argëtim filozofik

Thënie të mençura

- Me të njëjtën thjeshtësi që era çrrënjos një pemë të brishtë, tundimet tërheqin atë që është në kërkim të kënaqësive, që është i pangopur (lakmitar), dembel dhe i dobët. Por, si era që nuk mund të lëkundë një mal, asnjë tundim nuk lëkund të urtin, energjikun, të besueshmin që jeton thjesht.
- Ai që vesh rrobën e verdhë pa u pastruar, pa fituar dominimin e vetes e pa kërkuar të vërtetën, është i padenjë për ta veshur atë.
- Mposht njëmijë herë, njëmijë burra në betejë: vetëm ai që mund veten është luftëtari më i madh.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!